

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5781  
E hënë, 20 maj 2019  
çmimi 0.40 €

## Dy dhjetëvjetësia që nga krimi i pandëshkuar

FAQE 10

Sadik ZEQRIRI,  
ish-pjesëtar i UÇK-së, i  
mbijetuar në  
masakrën e Dubravës



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", SEJDI HOXHA ■ FAQE 4-5

## Zgjedhjet e brendshme do ta fuqizojnë PDK-në në nivel lokal dhe qendror



Kryetari i sapozgjedhur i Degës së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Drenas, Sejdi Hoxha, ka bërë me dije se koncepti i ri politik Dekada e Re e ka shtyrë t'i hyjë politikës dhe garës zgjedhore në këtë komunë. Ai ka vlerësuar se procesi

zgjedhor për të parin e PDK-së në Drenas ka qenë demokratik dhe transparent. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Hoxha është zotuar se do të punojë me përkushtim, nder dhe profesionalizëm. Ai ka thënë se me udhëheqjen e tij

do të vazhdohet tradita e fitoreve të PDK-së në Drenas. Sipas Hoxhës, fakti që në strukturat e PDK-së kanë ardhur njerëz entuziastë dhe të përgatitur është një parametër se PDK-ja do të fuqizohet në nivelin lokal dhe në atë qendror

NË KATËR KOMUNAT VERIORE TË KOSOVËS, NË MITROVICËN E VERIUT, LEPOSAVIQ, ZVEÇAN DHE ZUBIN POTOK, TË DIELËN JANË MBAJTUR ZGJEDHJET E JASHTËZAKONSHME PËR KRYETARË TË KËTYRE KOMUNAVE

## Zgjedhjet në veri u mbajtën në mënyrë të qetë

FAQE 3

-Dalja e votuesve në katër komunat veriore 42.42 për qind

Në Mitrovicën e Veriut, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok janë mbajtur të dielën zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetarë të këtyre komunave. Komisioni Qendror i

Zgjedhjeve (KQZ) ka bërë me dije se të gjitha vendvotimet janë hapur me kohë dhe se votimi ka shkuar në rregull. Dalja e votuesve në këto zgjedhje ka qenë mbi 42 për qind.

## Jeta, biznesi dhe sukseset në Amerikë të shqiptaro-amerikanit Mhill Gjuraraj

FAQE 12-13

Intervistoi: Lumturije BEKAJ



**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## AKTUALE

### JO TENTIM GJENOCIDI, POR GJENOCID

F.6

Ismet  
HAJRULLAHU



### NOCIONI 'PARAMILITAR' SI INSTRUMENT I MOHIMIT TË GJENOCIDIT

F.8

Shkruan: Bardhyl  
MAHMUTI



### FSK-ja MERR PJESË NË USHTRIMIN E NATO-S 'IMMEDIATE RESPONSE-19'

F.7

## EKONOMI

### PËR KATËR MUAJ NË KOSOVË U REGJISTRUAN 3 294 BIZNESE

F.9

### MURTEZAJ: BORXHLINJTË NUK DO T'I FALIM MË

F.9

## SPORT

### FERONIKELI SHPALLET KAMPION I KOSOVËS

F.18





# Basha: Shkëmbimi i territoreve kërcënon paqen dhe stabilitetin rajonal

Lulzim Basha ka ndarë me miqtë britanikë qëndrimin e qartë dhe të vendosur të Partisë Demokratike, se përpjekjet dhe diskursi mbi kufijtë dhe shkëmbimin e territoreve shkon kundër këtyre arritjeve, duke kërcënuar paqen dhe stabilitetin rajonal dhe minuar perspektivën evropiane të vendeve dhe popujve të rajonit



LONDËR, 19 MAJ - Në mbyllje të vizitës së tij në Britani të Madhe, lideri i Partisë Demokratike (PD), Lulzim Basha, ishte i ftuar i nderit në një darkë pune me anëtarë të Parlamentit dhe Dhomës së Lordëve në Londër.

Mes pjesëmarrësve në këtë darkë pune ishte lordi George Robertson, ish-sekretar i përgjithshëm i NATO-s dhe anëtar i Dhomës së Lordëve. Në darkë ishin të pranishëm edhe deputetët Crispin Blunt, Sir Mark Lyall Grant, dhe Gavin Williamson, anëtar i Parlamentit britanik dhe lider-shipit të konservatorëve dhe ish-ministër i Mbrojtjes. Gjithashtu në darkë ishte i pranishëm edhe sir Hugh Orde, ish-kryedrejtes i Shërbimeve të Sigurisë në Irlandën e Veriut. Në qendër të diskutimeve ishte siguria dhe stabiliteti në Evropën Juglindore dhe kriza

politike në Shqipëri. Në fjalën e tij gjatë darkës, kryetari Basha ka shprehur mirënjohjen për ndihmën e çmuar të Britanisë së Madhe për kapërcimin me sukses të sfidave jetike për paqen dhe stabilitetin në Ballkan, në veçanti në luftën e Kosovës dhe procesin e pavarësimit të saj, në konfliktin e armatosur në Maqedoni e Marrëveshjen e Ohrit dhe, së fundmi, Marrëveshjen e Prespës që shërben për ta konsoliduar perspektivën afatgjatë euroatlantike të rajonit, duke garantuar anëtarësimin e saj në NATO.

Basha ka ndarë me miqtë britanikë qëndrimin e qartë dhe të vendosur të Partisë Demokratike se përpjekjet dhe diskursi mbi kufijtë dhe shkëmbimin e territoreve shkon kundër këtyre arritjeve, duke kërcënuar paqen dhe stabilitetin rajonal dhe minuar

perspektivën evropiane të vendeve dhe popujve të rajonit. "Autokratët e korruptuar përbëjnë një kërcënim për demokracinë dhe stabilitetin. Kriza e thellë në Shqipëri ilustron qartë se pa demokraci dhe sundim të ligjit nuk mund të ketë stabilitet dhe as zhvillim ekonomik", tha ai.

"Forcimi i institucioneve demokratike, kontrolli dhe kufizimi i pushteteve, drejtësia e pavarur dhe zgjedhjet e lira janë parakusht për integrimin e vendeve tona në BE. Zgjedhjet e

lira dhe të ndershme janë jetike për demokracinë dhe legjitimitetin e qeverisë para qytetarëve. Për këtë qëllim hapi më emergjent është shkëputja e lidhjeve të provuara mes kriminit të organizuar dhe politikës", ka thënë Basha.

Më tutje, Basha i ka informuar bashkëbiseduesit me propozimet e PD-së dhe opozitës së bashkuar për daljen nga kriza politike në Shqipëri përmes një procesi të lirë zgjedhor nën kujdesin e një qeverie transitore. "Vetëm një qeveri e dalë nga vota e lirë mund

të luftojë krimin e organizuar që e ka shndërruar Shqipërinë, sipas raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit, në një bazë operationale të rrjeteve kriminale, që vepron nga Amerika në Evropë dhe Lindjen e Mesme", ka thënë Basha.

Basha i njoftoi miqtë britanikë edhe me programin e Partisë Demokratike, në veçanti me masat që do të marrë përmes vetingut të politikanëve dhe goditjes me tolerancë zero të kriminit dhe konfiskimit të aseteve kriminale.

## Lleshaj: 50 oficerë të FRONTEX në kufirin shqiptar



TIRANË, 19 MAJ - Ministri i Brendshëm Sandër Lleshaj ka zhvilluar një vizitë në Qarkun e Korçës. Gjatë vizitës, ministri ka pasur takim me studentët e Universitetit "Fan Noli" si dhe ka vizituar Bashkinë e Korçës. Po ashtu, ai ka pasur takim dhe me drejtues të pikave kufitare Kapshticë dhe Qafë Thanë, ku i bëri me dije se pritet që nga java tjetër 50 oficerë të Frontex të vendosen në kufirin shqiptar. "Në Qarkun Korçë, me një bashkëbisedim shumë interesant me studentët të "Fan Nolit".

Pakti për Universitetin është në një fazë intensive të zbatimit, por puna vazhdon", njofton Ministria e Brendshme.

"Në sallën e re të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Korçë, në një takim me drejtues të pushtetit vendor në Qark, përfaqësues të autoriteteve lokale dhe drejtues në nivel qendror e vendor të Policisë, me fokus sigurinë publike, përgatitjet për zgjedhjet vendore të 30 qershorit, luftën kundër kanabisit dhe përmirësimin e shërbimeve për qytetarët", thuhet në njoftim.

"Në Pikën Kufitare Kapshticë dhe Qafë Thanë për sezonin turistik ku priten flukse vizitorësh, si dhe masat për parandalimin migracionit të paligjshëm. Nga java e ardhshme rreth 50 trupa të FRONTEX do të vendosen në kufirin shqiptar, si bashkëpunimi i parë i BE-së me një vend të rajonit. Zyra e shërbimeve për qytetarët në Komisaratin e Policisë Pogradec, ishte një tjetër ndalesë gjatë vizitës në Qark", bëhet me dije nga Ministria e Brendshme.

## PD-LSI nuk marrin asnjë qindarkë nga buxheti i shtetit

TIRANË, 19 MAJ - Kuvendi ka përjashtuar PD-LSI dhe aleatët nga fondet që rrjedhin nga buxheti i shtetit për zgjedhjet vendore të 30 qershorit. Përfutuese të fondit për 65 milionë lekësh të reja që do të shpërndahet nga KQZ-ja janë vetëm partitë e regjistruara në zgjedhje. Vendimi i parlamentit u krijon mundësi partive të reja, mes tyre edhe të sapokri-

juarës Bindjes Demokratike, që të përfitojnë fonde në fushatë. Projektvendimi i miratuar në seancën e fundit parlamentare sanksionon se sasia e fondit nga buxheti i shtetit do t'u akordohet atyre partive politike të regjistruara si subjekte zgjedhore, ndërsa mbetet e pa përcaktuar mënyrën se si do të ndahet kjo vlerë. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

për këtë çështje do të veprojë mbi bazën e neneve 87 dhe 88 të Kodit Zgjedhor, ku përcaktohet në mënyrë specifike se si shpërndahet ky fond.

Neni 87, pika 1 përcakton se partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje dhe që kanë marrë jo më pak se 0,5 për qind të votave në shkallë vendi, përfitojnë fonde nga buxheti i shtetit në

bazë të numrit të votave që secila parti ka marrë në ato zgjedhje. Fondi për këtë qëllim përcaktohet me vendim të Kuvendit dhe përbën zë më vete në buxhetin e shtetit për vitin zgjedhor përkatës.

Në kushtet kur Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim dhe forcat e tjera opozitare që nuk janë

regjistruar në zgjedhje janë përjashtuar, Partia Socialiste pritet të marrë pjesën më të madhe të fondit, më shumë se 85 për qind. Referuar Kodit Zgjedhor, 5 për qind e këtij fondi shkon për partitë politike që hyjnë për herë të parë në zgjedhje, ku përfutuese do të jetë edhe Bindja Demokratike e krijuar së fundmi nga Astrit Patozi.



Në katër komunat veriore të Kosovës, në Mitrovicën e Veriut, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok, të dielën janë mbajtur zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetarë të këtyre komunave

## Zgjedhjet në veri u mbajtën në mënyrë të qetë

*-Dalja e votuesve në katër komunat veriore 42.42 për qind*

Në Mitrovicën e Veriut, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok janë mbajtur të dielën zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetarë të këtyre komunave. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka bërë me dije se të gjitha vendvotimet janë hapur me kohë dhe se votimi ka shkuar në rregull. Dalja e votuesve në këto zgjedhje ka qenë mbi 42 për qind. Ndërsa koalicioni i OJQ-ve "Demokracia në Veprim" që ka vëzhguar zgjedhjet në veri ka përmendur disa probleme të vogla që e kanë përcjellë këtë proces zgjedhor



EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 19 MAJ - Zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetarë të Komunës së Mitrovicës së Veriut, Leposaviqit, Zveçanit dhe Zubin Potok kanë shkuar mirë dhe pa ndonjë problem. Dalja e votuesve në këto zgjedhje ka qenë 42.42 për qind.

Sipas komunave, dalja në zgjedhje në Leposaviq ishte, 41.57 për qind, në Zubin Potok 50.74 për qind, në Zveçan 48.17 për qind dhe në Mitrovicën Veriore 38.74 për qind.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) dhe koalicioni i OJQ-ve "Demokracia në Veprim" që ka vëzhguar këtë proces kanë vlerësuar se të gjitha vendvotimet janë hapur me kohë dhe se votimi është zhvilluar në rregull. Po ashtu, KQZ-ja dhe DnV-ja kanë raportuar gjatë ditës së diel për disa parregullsi të vogla gjatë këtij procesi zgjedhor.

Institucioni që i ka organizuar këto zgjedhje ka bërë me dije se disa komisionarë e kishin të paqartë se me cilat dokumente identifikimi duhet të votojnë qytetarët, duke shtuar se menjëherë atyre u është bërë e qartë se dokumentet valide janë ato të Republikës së Kosovës. Ndërsa DnV-ja ka treguar se parregull-

sitë më të shpeshta që kanë përcjellë këtë proces zgjedhor kanë qenë: votimi familjar, ankesa lidhur me listën e votuesve, votimi jashtë kabinës dhe tentime për të votuar më shumë se një herë.

Në fillim të këtij procesi zgjedhor presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, i ka ftuar kandidatët për kryetarë të katër komunave për një garë korrekte, duke thënë se këto zgjedhje janë në shërbim të integritetit sa më të mirë të të gjitha komuniteteve në institucionet e Kosovës.

"Subjektet politike dhe qytetarët i përgëzoj për fushatën e qetë në katër komunat veriore të Kosovës dhe uroj proces të rregullt zgjedhor. Kosova ka ndërtuar traditë të zgjedhjeve të suksesshme. Zgjedhjet në katër komunat veriore të Kosovës po mbahen sipas ligjeve të Republikës së Kosovës dhe janë në shërbim të integritetit sa më të mirë të të gjitha komuniteteve në institucionet e Kosovës. Kandidatëve për kryetarë u uroj suksese dhe i ftoj që të vazhdojnë të punojnë për përmirësimin e jetës së qytetarëve në komunat e tyre", ka thënë Thaçi.

Ndërkaq shefja e zyrës së BE-së në Kosovë, Nataliya Apostolova, ka shkuar në veri për ta parë nga afër mbarëvajtjen e proce-

sit zgjedhor. Nga atje, ajo ka thënë se zgjedhjet në veri janë shumë të rëndësishme për Kosovën. Apostolova ka theksuar se ka vërejtur një proces të mirë, por ka dhënë vërejtje rreth listave të votimit. Shefja e BE-së në Kosovë shpreson që asnjëri nga kryetarët që do të zgjedhen nga ky proces nuk do të japin dorëheqje ashtu siç ka ndodhur herën e kaluar pasi, sipas saj, Bashkimi Evropian ka shumë fonde për të dhënë për gjithë Kosovën, natyrisht edhe për veriun. "BE-ja pret që të gjithë aktorët e përfshirë në zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetarë në katër komunat në veri të Kosovës ta respektojnë integritetin e procesit zgjedhor. BE-ja thekson rëndësinë e respektimit dhe zbatimit të rekomandimeve të Misionit Vëzhgues të BE-së nga zgjedhjet e kaluara", ka theksuar Apostolova.

Nën mbikëqyrjen e Koordinatorës Nacionale për

zgjedhje, Laura Pula, Prokuroria Themelore e Mitrovicës, e udhëhequr nga kryeprokurori Shyqyri Sylja, është angazhuar me prokurorë dhe staf mbështetës, për monitorimin e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetarë të komunave, Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovica e Veriut.

Deri në përmbyllje të procesit nuk ka pasur asnjë rast që mund të ndikojë në prishjen e procesit të votimit. Në zgjedhjet për kryetarë të këtyre komunave kanë garuar kandidatët nga Lista Serbe, Partia Demokratike e Kosovës dhe Lëvizja Vetëvendosje. Bazuar në renditjen e KQZ-së, në garë për kryetar të Leposaviqit kanë qenë Fisnik Veseli nga Lëvizja Vetëvendosje, Shaqir Hetemi nga Partia Demokratike e Kosovës dhe Zoran Todiç nga Lista Serbe.

Në Zubin Potok kanë garuar Liridona Kahrmani nga Lëvizja Vetëvendosje, Hysen Mehmeti

nga Partia Demokratike e Kosovës dhe Sërshan Vullović nga Lista Serbe.

Në Zveçan, për kryetarin e kësaj komune, kanë garuar, Avdi Peci nga Lëvizja Vetëvendosje, Ilir Peci nga Partia Demokratike e Kosovës dhe Vuçina Janković nga Lista Serbe. Kurse, në Mitrovicën e Veriut kanë garuar, Erden Atiq nga Lëvizja Vetëvendosje, Gonxhe Çausi nga Partia Demokratike e Kosovës dhe Goran Rakiç nga Lista Serbe.

Zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetarë të këtyre katër komunave janë zhvilluar në 44 qendra votimi me 87 vendvotime.

Kryetarët e komunave veriore, Zubin Potok, Zveçan, Mitrovicë e Veriut dhe Leposaviq, më 26 nëntor të vitit të kaluar dhanë dorëheqje në shenjë pakënaqësie ndaj vendosjes së taksës doganore prej 100 përqindësh nga Qeveria e Kosovës për importet nga Serbia.

## Limaj në Slloveni: Diaspora të mobilizohet për zhvillimin e Kosovës

PRISHTINË, 19 MAJ (ER) - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, pas vizitës në Blerin, ka qëndruar për vizitë edhe në Slloveni. Limaj ka zhvilluar një takim me bashkatdhetarët në Slloveni, ku ishte i shoqëruar edhe nga deputeti i Nismës

Socialdemokrate, Enver Hoti. "Bashkë me deputetin Hoti u shprehëm mirënjohje dhe falënderim mërgimtarëve tanë në diasporë, përkatësisht në Slloveni, për atë ç'kanë bërë për zhvillimin e vendit. Mërgata ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm për lirinë të

cilën e gëzojmë sot. Ne duhet të ndihemi me fat që kurorëzuar ëndrrën e baballarëve tanë për ta pasur shtetin tonë", ka thënë Limaj. Ai ka theksuar se diaspora, siç ka pasur rol të madh në arritjen e lirisë, duhet të mobilizohet edhe për zhvillimin e Republikës së Kosovës.





Flet për "Epokën e re", Sejdi Hoxha

# Zgjedhjet e brendshme do ta fuqizojn



Kryetari i sapozgjedhur i Degës së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Drenas, Sejdi Hoxha, ka bërë me dije se koncepti i ri politik Dekada e Re e ka shtyrë t'i hyjë politikës dhe garës zgjedhore në këtë komunë. Ai ka vlerësuar se procesi zgjedhor për të parin e PDK-së në Drenas ka qenë demokratik dhe transparent. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Hoxha është zotuar se do të punojë me përkushtim, nder dhe profesionalizëm. Ai ka thënë se me udhëheqjen e tij do të vazhdohet tradita e fitoreve të PDK-së në Drenas. Sipas Hoxhës, fakti që në strukturat e PDK-së kanë ardhur njerëz entuziastë dhe të përgatitur është një parametër se PDK-ja do të fuqizohet në nivelin lokal dhe në atë qendror


**EPOKA  
ERE****Shqipe HETEMI**

**PRISHTINË, 19 MAJ** - Kryetari i Degës së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Drenas, Sejdi Hoxha, është zotuar se do të punojë me përkushtim dhe profesionalizëm. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se komunikimi, transparenca dhe llogaridhënia do të jenë tri shtyllat kryesore të mandatit të tij. "Kuadrot e reja kanë potencial dhe energji për ta dhënë kontributin e tyre për fuqizimin e PDK-së. Do të punoj me

përkushtim të madh, përgjegjësi, nder dhe profesionalizëm. Së bashku do ta vazhdojmë traditën e fitoreve të PDK-së në Drenas, në bastionin e pathyeshëm të PDK-së", është shprehur Hoxha, duke shtuar se vizioni i liderit Kadri Veseli dhe koncepti i ri politik Dekada e Re e kanë shtyrë që t'i bashkohet kësaj partie. "Më ka pëlqyer vizioni i kryetarit Kadri Veseli dhe lansimi i projektit Dekada e Re ka qenë inspirim për mua dhe për të gjithë të rinjtë. Me herët kam qenë simpatizant i PDK-së, por jo anëtar i strukturave



# ë PDK-në në nivel lokal dhe qendror



dhe nuk kam mbajtur ndonjë pozitë. Vizioni që ka lansuar lideri ynë Kadri Veseli për Dekadën e Re më ka shtyrë dhe më ka motivuar që të jem pjesë e garës për Degën e PDK-së në Drenas", ka theksuar ai. Sipas Hoxhës, fakti që në strukturat e PDK-së kanë ardhur njerëz entuziastë dhe të përgatitur është një parametër se PDK-ja do të fuqizohet si në nivelin lokal, po ashtu edhe në atë qendror pas këtij procesi zgjedhor. "Në shumicën e degëve të PDK-së ka pasur një entuziazëm të pjesëmarrjes së qytetarëve të Republikës së Kosovës për t'u bërë pjesë e strukturave të PDK-së. Fakti që në strukturat e PDK-së kanë ardhur njerëz shumë entuziastë dhe të përgatitur është një parametër dhe një dritë e gjelbër se PDK-ja pa dyshim do të fuqizohet si në nivelin lokal, po ashtu edhe në atë qendror pas këtij procesi zgjedhor", ka deklaruar ai.

Hoxha, i cili është edhe kryeshef ekzekutiv i Postës së Kosovës, ka bërë me dije se do të konsultohet me Agjencinë Kundër Korrupsionit për ta vërtetuar nëse mbajtja e dy pozitave nga ana e tij përbën shkelje të ligjit apo jo. "Përderisa nuk vërtetohet nga institucionet ligjore përgjegjëse nuk do të jap dorëheqje. Në momentin që mekanizmat ligjorë institucionalë, siç është Agjencia Kundër Korrupsionit, jep ndonjë vendim, 100 për qind do të jem zbatues i ligjit. Kurrë në jetën time nuk do të jem shkelës i ligjit", ka thënë Hoxha.

**"Epoka e re":** Z. Hoxha, të shtunën jeni zgjedhur kryetar i Degës së Partisë Demokratike të Kosovës në Drenas, cilat janë arsyet që vendoset t'i hyni politikës dhe pse pikërisht në PDK?

**Hoxha:** Më ka pëlqyer vizioni i kryetarit Kadri Veseli dhe

lansimi i projektit Dekada e Re ka qenë inspirim për mua dhe për të gjithë të rinjtë. Më herët kam qenë simpatizant i PDK-së, por jo anëtar i strukturave dhe nuk kam mbajtur ndonjë pozitë. Vizioni që ka lansuar lideri ynë Kadri Veseli për Dekadën e Re më ka shtyrë dhe më ka motivuar që të jem pjesë e garës për Degën e PDK-së në Drenas. Së bashku me mua edhe shumë të rinj profesionistë të fushave të ndryshme kanë hyrë dhe kanë fituar garën për t'u zgjedhur qoftë delegatë në këshill drejtues qoftë edhe në konventën zgjedhore të partisë.

**"Epoka e re":** Si e vlerësoni këtë proces zgjedhor dhe sa ishte e vështirë për ju që ta merrni këtë pozitë?

**Hoxha:** Gara ka qenë jashtëzakonisht e mirë dhe transparente. Edhe numërimi i votave ka qenë me standarde shumë të larta, ndoshta i vetmi në Kosovë ku çdo votë është pasqyruar në monitor dhe secili kandidat ka pasur mundësi ta shohë votimin që i kanë dhënë delegatët për kryetar të degës, por edhe për pozita të tjera. Gara ka qenë transparente dhe demokratike, por jo edhe e lehtë, për arsye se kanë qenë tre kandidatë. Me këtë rast i falënderoj delegatët që më kanë dhënë besimin për ta udhëhequr Degën e PDK-së në Drenas. Ndihej vërtet krenar që është vlerësuar vizioni im politik.

**"Epoka e re":** kundërkandidati juaj, z. Naim Bazaj, ka shprehur pakënaqësi dhe ka thënë se për zgjedhjen tuaj në krye të degës i ka 'shti duart kryesia'. Është e vërtetë një gjë e tillë?

**Hoxha:** Z. Bazaj ka treguar pjekuri të lartë dhe në momentin që janë shpallur rezultatet më ka uruar për zemërsisht, prandaj e falënderoj për sjelljen korrekte. Edhe kundërkandidati

tjetër z. Kushtrim Prenku më ka telefonuar dhe më ka uruar për zgjedhjen në këtë pozitë. Gara ka qenë fer, por secili ndoshta ka pasur të drejtë të ndihet i zhgënjyer meqenëse të gjithë kandidatët që i kemi hyrë garës kemi pritur fitore. Në këto zgjedhje nuk ka fitues dhe humbës. Në këto zgjedhje ka fituar koncepti i ri politik Dekada e Re. Ka fituar Partia Demokratike e Kosovës.

**"Epoka e re":** Sa do të jetë sfidues drejtimi i Degës së PDK-së në Drenas duke pasur parasysh se ju më herët nuk keni qenë pjesë e strukturave?

**Hoxha:** Kur fillojnë zgjedhjet nuk i garantojnë askujt pozitë ex officio, do të thotë çdo proces zgjedhor nis nga fillimi. Për vetë faktin se ne kemi marrë një mbështetje jashtëzakonisht të mirë të strukturave të partisë, jam shumë i sigurt se me një përbërje të tillë të këshillit drejtues, kuvendit të degës dhe të kryesisë që do të vijë, do të kemi rezultate shumë më të mira të fuqizimit të mëtejshëm të PDK-së në Drenas.

**"Epoka e re":** Cilat do të jenë planet dhe prioritetet gjatë këtij mandati dhe çfarë ndryshimi do të bëni në këtë degë?

**Hoxha:** Komunikimi, transparencja dhe llogaridhënia do të jenë tri shtyllat kryesore që do të përqendrohemi për fuqizimin e Dekadës së re. Qytetarët do të vazhdojnë t'i besojnë lidërshiptit të PDK-së në nivelin lokal dhe në nivelin qendror duke marrë për bazë se kemi pasur një garë demokratike dhe transparente ku u kemi dhënë hapësirë të gjithë kuadrove që të jenë pjesë e procesit zgjedhor, të zgjedhin dhe të jenë të zgjedhur. Kuadrot e reja kanë potencial dhe energji për ta dhënë kontributin e tyre për fuqizimin e PDK-së. Do të

punoj me përkushtim të madh, përgjegjësi, nder dhe profesionalizëm. Së bashku do ta vazhdojmë traditën e fitoreve të PDK-së në Drenas, në bastionin e pathyeshëm të PDK-së.

**"Epoka e re":** Z. Hoxha, këto zgjedhje, çfarë do t'i sjellin PDK-së në Drenas dhe në nivel vendi në përgjithësi?

**Hoxha:** Në shumicën e degëve të PDK-së ka pasur një entuziazëm të pjesëmarrjes së qytetarëve të Republikës së Kosovës për t'u bërë pjesë e strukturave të PDK-së. Fakti që në strukturat e PDK-së kanë ardhur njerëz shumë entuziastë dhe të përgatitur është një parametër dhe një dritë e gjelbër se PDK-ja do të fuqizohet në nivelin lokal dhe në atë qendror pas këtij procesi zgjedhor.

**"Epoka e re":** Do të jeni kandidat i PDK-së për kryetar të Komunës së Drenasit në zgjedhjet e ardhshme?

**Hoxha:** Është pyetje shumë e largët dhe nuk mund t'i japë përgjigje aktualisht.

**"Epoka e re":** Por nuk e mohoni një gjë të tillë?

**Hoxha:** Është vendim të cilin e sjell Kryesia e Partisë Demokratike të Kosovës dhe lideri i saj Kadri Veseli. Nuk më takon mua që të jap përgjigje për këtë çështje.

**"Epoka e re":** Z. Hoxha, tash meqë keni pozitë në parti, a do të jepni dorëheqje nga posti i kryeshefit ekzekutiv të Postës së Kosovës?

**Hoxha:** Përderisa nuk vërtetohet nga institucionet ligjore përgjegjëse nuk do të jap dorëheqje. Sapo që mekanizmat ligjorë institucionalë, siç është Agjencia Kundër Korrupsionit, jep ndonjë vendim, 100 për qind do të jem zbatues i ligjit. Kurrë në jetën time s'do ta shkel ligjin.

## Ish-presidenti Sejdiu: Kufijtë e Kosovës nuk mund të ndryshohen

Prishtinë, 19 maj - Ish-presidenti i Kosovës dhe ish-kryetari i LDK-së, Fatmir Sejdiu, ka thënë se kufijtë nuk mund të ndryshojnë. Në një intervistë për "Kosovapress", Sejdiu ka folur për Samitin e Berlinit, për idenë e presidentit Hashim Thaçi për korigjimin e kufijve dhe për rrezikun që Kosova mund të ketë në marrëdhëniet me miqtë e vet ndërkombëtarë. Sipas tij, asnjëherë nuk ka pasur ndonjë formulë nga miqtë

ndërkombëtarë ku thuhet se "mund të bëni çfarë të doni me kufijtë". Ai ka thënë se lëvizja e kufijve nënkupton destabilitet në rajon. Duke folur për veriun e Kosovës, Sejdiu ka thënë se Serbia ka arritur ta mbajë peng një pjesë të rëndësishme të qytetarëve serbë ku teledirigjohen nga Beogradi. Më tutje, Sejdiu ka theksuar se LDK-ja është duke gabuar me mosqëndrimin e saj për dialogun.





## Një familje skamnore bëhet me banesë të re në Skenderaj

SKENDERAJ, 19 MAJ (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ia ka dhuruar çelësat e banesës së re familjes Bajrami, e cila deri më tani ka jetuar në

kushte shumë të vështira. Kryefamiljari Behar Bajrami është shprehur shumë i lumtur për banesën e re, për të cilën ka kontribuar Blerim Fazliu dhe shoqata "Jetimat

Ballkanit" me humanistin Halil Kastrati. Kryetari Jashari është shprehur i kënaqur që po arrihet të ndihmohen familjen në nevojë, duke theksuar se nuk ka më mirë se veprat

e mira të bëhen sidomos gjatë muajit të shenjtë të ramazanit. Jashari ka falënderuar të gjithë njerëzit vullnetmirë të cilët po kontribuojnë në mirëqenien e qytetarëve.



## Në Gjilan do të ngrehet shtatorja e heroit Abdullah Tahiri

GJILAN, 19 MAJ (ER) - Komuna e Gjilanit ka nisur aktivitetet për shënimin e 20-vjetorit të rënies së heroit të kombit Abdullah Tahiri. Me këtë rast, kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, ka thënë se kjo komunë është duke e vazhduar traditën e respektit për të gjithë ata që janë flijuar për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. "Bashkë me shumë të burgosur të luftës, Abdullah Tahiri, ashtu siç ka qenë edhe në jetë i vrullshëm dhe kryengritës, ka rënë dëshmor për këtë vend. Për këto pesë vjet Gjilani po vazhdon traditën e respektit dhe gjunjëzimit për të gjithë ata që kanë dhënë kontribut të veçantë. Jam shumë i nderuar që në këtë mandat po realizohet edhe shtatorja e Abdullah Tahirit", ka thënë Haziri.

Ai ka thënë se është i nderuar që ka pasur fatin të bashkëpunojë me heroin Tahiri. "Kam pasur fatin që të njihem në dy periudha të rënda: prej vitit 1989 deri në burgosje dhe në periudhën e burgosjes në burgun hetues të Gjilanit ku kam kaluar bashkë me të pasi ishim pjesë e grupit të përbashkët të akuzuar për terrorizëm dhe veprimtari armiqësore nga regjimi i kohës. Jam krenar që këto dy periudha i kam kaluar me të. Lavdi e përjetshme!", ka theksuar Haziri. Kryetari i Gjilanit ka paralajmëruar se këtë vit do të vendoset edhe shtatorja e mulla Idriz Gjilanit, riorganizimi dhe renovimi i shtatores së Agim Ramadanit, fillimi i inicimit për shtatoren e Kadri Zekës si dhe do të vlerësohet edhe figura e Ramiz Cernicës.



## Në 20-vjetorin e rënies, përkujtohet dëshmori Enver Topalli

FERIZAJ, 19 MAJ (ER) - Kryetari i Ferizajt, Agim Aliu, bashkë me deputetët e PDK-së, Elmi Reçica dhe Mexhide Mjaku-Topalli, kryetarin e Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve në Ferizaj, Gafurr Bytyçin, kryetarin e OVL-UÇK-së në Ferizaj, Rafiz Sejdiu, familjarë të dëshmorit Enver Topalli dhe qindra qytetarë, kanë vendosur kurora me lule në varrin e dëshmorit Topalli në 20-vjetorin e rënies së tij, në masakrën e Dubravës. Me dhembje e pikëllim dhe krenari, në 20-vjetorin e rënies dëshmorin Topalli e ka përkujtuar i biri i tij, Edlir Topalli. "Sot jemi mbledhur ta përkujtojmë babanë në 20-vjetorin e rënies në Burgun e Dubravës. Lavdi për të gjithë dëshmorët

e Kosovës që kanë rënë dhe dhënë jetën që ne sot të jemi të lirë dhe ta gëzojmë lirinë" ka thënë Edliri. Ndërsa kryetari i Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve në Ferizaj, Gafurr Bytyçi, e ka vlerësuar lart heroizmin e dëshmorit të kombit Enver Topalli dhe sakrificën e gjithë dëshmorëve dhe të rënëve për lirinë e Kosovës. "Ne si shoqatë e familjeve të dëshmorëve dhe si komb patjetër se krenohemi me jetën dhe veprimtarinë e Enver Topallit i cili nuk kurseu asgjë nga jeta për kombin dhe atdheun", ka thënë Bytyçi. Përkujtimi për dëshmorin Topalli ka vazhduar edhe në Greme në shkollën e fshatit që mban emrin e tij.



## Vazhdojnë investimet infrastrukturore në fshatrat e Deçanit

Deçan, 19 maj (ER) - Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka bërë me dije se është duke u rinovuar rruga kryesore

në fshatin Llukë të kësaj komune. "Po punohet për renovimin dhe asfaltimin e rrugës kryesore në fshatin Llukë, segmentet nga

Lluka deri në Pozhar dhe segmenti i rrugës së UÇK-së nga qendra në Podin e Gështenjave", ka deklaruar Ramosaj. Po ashtu,

Ramosaj ka bërë me dije se kanë filluar punimet për rregullimin e rrugëve edhe në fshatin Baballoq të Komunës së Deçanit.





# Zhdoganimi dhe tregu i zi pakësojnë blerjet online

Blerjet online, një trend mjaft i përhapur në gjithë botën, gjatë dy vjetëve të fundit në Kosovë po shënon rënie. Viti 2016 shënon herën e fundit kur kjo formë blerjeje ka pasur rritje në krahasim me vitin paraprak (2015)

**PRISHTINË, 19 MAJ** - Sipas të dhënave të prezantuara nga Posta e Kosovës, në vitin 2016 ka pasur rreth 250 mijë dërgesa online, kurse një vit më vonë, në 2017-n, numri i tyre ka qenë rreth 230 mijë. Trendi në rënie e ka përcjellë edhe vitin 2018, gjatë të cilit numri i blerjeve online, përmes Postës së Kosovës, ka qenë 220 mijë ose 4 për qind më pak se viti paraprak.

Rifat Alaj, menaxher i Qendrës Transite Postare në Postën e Kosovës, tregon se në katërmujorin e parë të këtij viti ka përgjysmë më pak blerje online krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. "Gjatë vitit 2017 totali i dërgesave online ishte 230 mijë e 492 copë, ndërsa gjatë vitit 2018 totali i dërgesave online ishte 220 mijë e 763 copë. Pra, në periudhën kohore janar - dhjetor 2018 vëllimi fizik ishte më i vogël për 9 729 copë dërgesa online, ose 4 për qind më pak se në vitin 2017. Kurse në katërmujorin e parë të këtij viti, janar - prill 2019, vëllimi fizik është 49 mijë e 677 copë dërgesa online që, krahasuar me katërmujorin e parë të vitit 2018 (janar - prill 2018, që ishte 92 mijë e 145 copë), në këtë vit është shumë më i vogël, për 42 mijë e 468 copë, ose 54 për qind më pak", ka treguar Alaj.

Legjislacioni në fuqi parasheh që dërgesat e blerjeve online, të cilat tejkalojnë vlerën 22 euro, duhet t'i nënshtrohen zhdogani-

nimit.

Nga procesi i zhdoganimit të produkteve të blera në këtë formë, sipas zëdhënësit të Doganës së Kosovës, Adriatik Stavileci, vitin e kaluar ky institucion ka arkëtuar rreth 270 mijë euro. "Numri i dërgesave të ndalura për zhdoganim (gjatë vitit 2018) është 11 500. Të zhdoganuara janë 7 110 dërgesa dhe të hyrat e inkasuara nga këto dërgesa me procedurat e zhdoganimit të thjeshtëzuar janë 183 715 euro dhe me procedurë janë zhdoganuar 390 dërgesa dhe të hyrat e inkasuara nga këto dërgesa me procedurat e zhdoganimit IM4 (importit të rregullt) janë 86 850 euro", ka thënë Stavileci përmes një përgjigjeje me shkrim.

Ndërsa në katërmujorin e parë të këtij vitit nga blerjet online Dogana ka arkëtuar më shumë se 76 mijë euro. "Numri i blerjeve online për periudhën janar - prill 2019 është 3 mijë e 296 dërgesa të ndalura për zhdoganim, të zhdoganuara janë 2 mijë e 320 dërgesa dhe të hyrat e inkasuara nga këto dërgesa me procedurat e zhdoganimit të thjeshtëzuar janë 58 mijë e 136 euro dhe me procedurë janë zhdoganuar 140 dërgesa dhe të hyrat e inkasuara nga këto dërgesa me procedurë të zhdoganimit IM4 janë 18 mijë e 434 euro", ka shpjeguar Stavileci.

Pikërisht limiti i ulët tarifor i zhdoganimit të dërgesave të



blerjeve online (deri në 22 euro), krahas "rritjes së tregut të zi online", sipas Rifat Alajt, përbëjnë faktorët kryesorë në rënieën e vazhdueshme të kësaj forme të blerjeve në Kosovë. Alaj vlerëson se ky limit është tepër i ulët në krahasim me vendet e rajonit ku, sipas tij, limiti shkon deri në 150 euro. "Siç po shihet, vazhdimisht ka rënie nga viti në vit. Ndër faktorët kryesorë të kësaj rënieje janë: 'tregu i zi i blerjeve online', që po lulëzon gjithandej nëpër Kosovë dhe 'limiti i ulët tarifor i vlerës së zhdoganimit të dërgesave i përcaktuar nga Dogana e Kosovës', e që është deri në 22 euro, klienti lirohet nga zhdoganimi. Kurse mbi 22 euro, klienti duhet të paguajë zhdoganimin e dërgesës që, bashkë me TVSh-në, bëjnë 29.5 për qind të vlerës së dërgesës. Për dallim nga Kosova, krahasuar me shumë vende të rajonit, limiti i vlerës së tarifës së zhdoganimit është më i përshtatshëm për klientët dhe shkon deri në 150 euro, që do të thotë deri në këtë limit tarifor

clienti lirohet nga zhdoganimi i dërgesës, që te ne është shumë i ulët", ka theksuar Alaj.

Menaxheri i Qendrës Transite Postare, Rifat Alaj, ka theksuar se vendet nga të cilat kosovarët blejnë më së shumti online janë Kina, Hong Kongu dhe Singapori, ndërsa në përqindje më të vogël edhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Britania e Madhe dhe Gjermania. Ai ka shtuar se pjesa dërrmuese e dërgesave arrijnë përmes Postës Shqiptare (Postës së Shqipërisë) për shkak se vijnë nga shtetet që nuk e kanë njohur Kosovën.

Për t'u siguruar që porosia e tyre do të arrijë në Kosovë, Alaj udhëzon qytetarët që t'i shmangin dërgesat përmes Serbisë. "Pjesa dërrmuese e rrugëtimit të këtyre dërgesave bëhet përmes rrugëve ajrore. Rreth 90 për qind e tyre në Kosovë arrijnë indirekt përmes Postës Shqiptare, sepse shtetet si Kina, Hong Kongu, Singapori etj., meqë nuk e kanë njohur ende shtetin e Kosovës, Kosova nuk figuron fare si shtet në

listën e tyre dhe se pikërisht për këtë arsye, dërgesat duhet të orientohen përmes shtetit shqiptar, i cili më pastaj i riorienton për në Kosovë. Përndryshe, nëse nuk do të orientoheshin në këtë mënyrë, këto shtete Kosovën e kanë në kodin postar shtetëror të Serbisë dhe dërgesat mund ta devijojnë rrugëtimit për Serbi dhe të mos vijnë fare në Kosovë. Bazuar në këtë fakt, adresimi nga dërguesit me rastin e porosive nga këto shtete duhet të bëhet në këtë mënyrë: emri dhe mbiemri, rruga dhe qyteti, shteti - Kosova dhe krejt në fund të shkruhet 'via-Albania', ka thënë ai.

Alaj ka theksuar se dërgesat e blerjeve online, përmes Postës së Kosovës, janë të sigurta dhe se qytetarët e kanë edhe mundësinë e gjurmimit të dërgesave të tyre. Produktet që blihen më së shumti online, sipas Alajt, janë pajisjet e ndryshme elektronike, veshmbathjet dhe suplementet e ndryshme, e në masë shumë të vogël edhe gjëra të ndryshme ushqimore. (REL)

## FSK-ja merr pjesë në ushtrimin e NATO-s 'Immediate Response-19'

**PRISHTINË, 19 MAJ (ER)** - Një kontingjent i FSK-së do të marrë pjesë në ushtrimin fushor të organizuar nga Ushtria Amerikane për Evropë (USAREUR) e cila realizon ushtrimin e përbashkët fushor me shtetet e NATO-s dhe me shtetet partnere, të quajtur "Immediate Response -19" (Përgjigjja e Menjëhershme-19).

FSK-ja merr pjesë me 45 pjesëtarë të Batalionit të Tretë të Brigadës së Reagimit të Shpejtë dhe Skuadrës së Çminimit (EOD).

Ushtrimi do të realizohet prej datës 20 maj deri më 8 qershor 2019 në Kroaci dhe Hungari.

Ushtrimi do të zhvillohet me ekzekutimin e stërvitjeve në terren në nivel batalioni, ku do të përfshijë pritjen, përqendrimin e trupave, lëvizjen tutje dhe integrimin, me qëllim kryesor të ndërveprimit në nivel taktik, në mes të ushtrive të shteteve pjesëmarrëse.

Pjesëtarët e Forcës së Sigurisë marrin pjesë në trajnime dhe ushtrime të ndryshme bilaterale dhe multilaterale, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, me qëllim që gjatë tërë kohës të jenë sa më të përgatitur, për të vepruar dhe punuar në mjedis të kombinuar shumëkombësh, si dhe të shkëmbejnë përvoja me shtetet partnere.





Shkrim drejtuar gazetarëve dhe atyre që merren me politikë

# Nocioni 'paramilitar' si instrument i mohimit të gjenocidit



Shkruan: Bardhyl MAHMUTI

Që në fillim të këtij shkrimi po tërheq vëmendjen se në të gjitha fazat e kryerjes së gjenocidit fshehja e krimin dhe shqetëson kriminelin. Në kontekst të fshehjes së krimin të gjenocidit nocioni "negacionizëm" nënkupton tërësinë e qëndrimeve të miratuara dhe shpjegimeve të dhëna për ta mohuar vërtetësinë e gjenocidit ose një krimi kundër njerëzimit. Në këtë aspekt, mohimi i gjenocidit mund të konsiderohet si pjesë përbërëse e krimin, e ndërthurur me të, sepse përcakton strategjinë e shkatërrimit të së vërtetës dhe kujtesës. Kur gjenocidi është kryer, atëherë kur e vërteta del në shesh, negacionizmi synon ta shkatërrtojë bindjen lidhur me krimin dhe të futë dyshime për vërtetësinë e krimin. Thënë shkurt, negacionizmi është organizim i gjenjeshtrës në një sistem, funksioni i të cilit është shmangia nga përgjegjësia e drejtpërdrejtë apo e tërthortë për kryerjen e gjenocidit. Fshehja e krimin të gjenocidit të kryer në Kosovë nga forcat e armatosura serbe ishte preokupim kryesor i shtetit serb. Meqenëse

vraska e civilëve shqiptarë në Kosovë ishte një fakt që askush nuk mund ta mohonte, pushteti i Beogradit aplikoi strategjinë e mohimit të implikimit të ushtrisë dhe policisë serbe në vrasjen e civilëve të paarmatosur. Duke qenë të vetëdijshëm se nocioni "grup paramilitar", si strukturë jashtë forcave të armatosur të një shteti, është shndërruar në instrument të manipulimit me opinionin publik në funksion të fshehjes së përgjegjësisë së strukturave politike dhe ushtarake të një shteti në kryerjen e krimeve të caktuara, propaganda serbe e futi në përdorim këtë nocion. Për vrasjen e civilëve në Kosovë para ndërhyrjes ushtarake të NATO-s, pushteti i Beogradit akuzonte "terroristët e UÇK-së dhe grupet paramilitare që kishin qenë jashtë kontrollit shtetëror serb". Pas ndërhyrjes ushtarake të NATO-s për të ndërprerë gjenocidin serb në Kosovë, propaganda serbe bënte përgjegjëse për vrasjen e civilëve "NATO-n, terroristët e UÇK-së dhe grupet paramilitare që kishin qenë jashtë kontrollit shtetëror serb". Fshehja e krimin të gjenocidit të kryer në Kosovë nga forcat e armatosura serbe dhe drejtimi i gishtit të "grupet paramilitare" është pjesë e strategjisë së Serbisë për t'i ikur përgjegjësisë si shtet. Si rezultat i propagandës së vazhdueshme të Beogradit për t'ua veshur krimin strukturave që gjoja

nuk kanë qenë në kontrollin e shtetit serb, këtë mendim e kanë përqafuar si të vërtetë një numër i konsiderueshëm politikanësh në shtetet perëndimore (komunistë, socialistë, social-demokratë, të së djathtës të vjetër e të re, neonazistë e neofashistë) si dhe historianë e politologë, filozofë e sociologë, gazetarë e publicistë, të orientimit të djathtë e të majtë. Fatkeqësisht edhe në diskursin tonë politik dhe mediatic nocioni "grupe paramilitare" ka zënë një vend të rëndësishëm, pa menduar për pasojat e mëdha që sjell përdorimi i këtij termi në shfajësimin e shtetit serb për krimin e gjenocidit. Të gjitha faktet nga burimet serbe, të cilat janë trajtuar më gjerësisht në librin tim "Mashtrimi i Madh", dëshmojnë se me vendim të Ministrisë së Drejtësisë të Qeverisë së Serbisë janë liruar nga burgu një numër i madh kriminelësh. Kriminelët e liruar nga burgjet u transferuan në qendra ushtarake për trajnim dhe për përgatitjen e tyre u ngarkuan nënkolonelët serbë Slobodan Stoishiqi dhe Miodrag Gjorgjeviqi. Këta nënkolonel të Armatës së Jugosllavisë i pajisi kriminelët me uniforma, me armë të mira, me mjete kimike dhe me mjete të tjera të nevojshme për likuidime. Krahas mjeteve për vrasje, kriminelët u pajisën me dokumente dhe simbole të përkatësisë së Sigurimit Ushtarak. Kriminelët u

integruan në Sigurimin ushtarak dhe ishin nën komandën e Slobodan Stoishiqit dhe Miodrag Gjorgjeviqit. Pas trajnimit të tyre, në muajin korrik të vitit 1998 ata u dërguan në Kosovë. Për ilustrim do të përmend rastin e grupit të quajtur "Garda Vullnetare Serbe" (Srpskadobrovolja? ka garda), i njohur me emrin "Tigrat", që ka reputacionin ndërkombëtar për shkak të kryerjes së një numri të madh të krimeve në Bosnje, në Kroaci dhe në Kosovë. Sipas dëshmimeve të publikuara në librin "Në follenë e tigrin" të ish komandantit të Njësisë për Operacione Speciale serbe, të njohur si "Beretat e Kuqe", Milorad Ulemek-Legija, i dënuar me 40 vjet burgim për implikimin në vrasjen e ish-kryeministrit serb Zoran Gjingjiq, "nuk është e vërtetë se gardën e krijuan kriminelët. Ajo u themelua nga patriotë serbë, të cilët nuk e kursyen vetën që të dalin në mbrojtje të popullit serb. Edhe sot, bëhet padrejtësi ndaj Gardës, duke e quajtur një formacion paraushtarak. Kjo nuk është e vërtetë. Që nga paraqitja e parë në Vukovar, Garda u vu nën komandën e APJ-së, dhe më vonë nën komandën e Ushtrisë së Krahinës Serbe". Ndërsa kur është në pyetje pjesëmarrja e tyre në krimet në Kosovë po përmend faktin se gjatë procesit gjyqësor kundër Slobodan Millosheviqit në Hagë, me 13

shkurt 2003, Aleksandar Vasiljeviq, zëvendës shefi i Drejtorisë së Sigurisë së Ushtrisë Jugosllave deklaroi se "Tigrat" e Arkanit ishin në kontrollin e drejtpërdrejtë të kolonelit të policisë speciale serbe Goran Radosavljeviq-Gurit. Gjenocidin në Kosovë e kreu Serbia përmes forcave të saja të armatosura me një zinxhir të qartë komandues nga institucionet politike, ushtarake dhe policore të shtetit serb. Është e kuptueshme që pushteti i Serbisë, qoftë i kohës së Millosheviqit, i Tadiqit apo i Vuçiqit aplikon strategjinë e negacionizmit për krimin e gjenocidit të kryer në Kosovë. Gjithashtu është e kuptueshme përpjekja e tyre për të zhvendosur fajësinë nga shteti serb te "grupet paramilitare të pakontrolluara nga shteti serb". Por, nuk është e drejtë që politikanë dhe gazetarë shqiptarë, në mënyrë të pavetëdijshme për pasojat që ka përdorimi i këtij termi, të përdorin nocionin "paramilitar". Për ta hequr përdorimin e gabueshëm dhe shumë të dëmshëm të këtij nocioni, një rol të madh mund ta luajnë gazetarët, sepse kanë pushtet të fuqishëm për krijimin e opinionit se kushdo qoftë që përdor nocionin "grup paramilitar", me vetëdije apo pa vetëdije, bëhet pjesë e shfajësimit të Serbisë për krimin e gjenocidit.

## Jo tentim gjenocidi, por gjenocid



Ismet HAJRULLAHU

Z. Surroi, për t'ua bërë qejfin qarqeve të disa shteteve që tradicionalisht e mbështesin Serbinë, duke e mohuar gjenocidin, apo duke reduktuar atë në "tentim për gjenocid", jo vetëm se nuk ndihmon në zgjidhjen e çështjeve ende të pazgjidhura të Kosovës por, në fakt, ushqen edhe më shumë krizën për konflikte të mëtejshme.

"Historia e vërtetë e njerëzimit do të shkruhet vetëm atëherë kur në të të marrin pjesë shqiptarët" Maksimilan Lambertz

Historikisht, Serbia, Mali i Zi, Mbretëria Jugosllave, në periudhën midis dy luftërave botërore si dhe Jugosllavia e Titos dhe e Millosheviqit ushtruan një gjenocid të vazhdueshëm e të paparë ndonjëherë, vetëm për ta nënshtruar e asimiluar ose shpërngulur popullsinë shqiptare, duke synuar shkombëtarizimin dhe sllavizimin

apo edhe turqizimin e tyre. Lidhur me këtë çështje dua të përmend disa fakte historike që tregojnë qartazi gjenocidin serb të ushtruar në vazhdimësi mbi shqiptarët dhe që hedhin poshtë mendimin e z. Surroi se në Kosovë është bërë vetëm një "tentim gjenocidi". Në vitin 1878, gjatë pushtimit të "Serbisë së Jugut" (Sanxhakut të Nishit), nga ushtritë serbe u vranë mbi 35 000 shqiptarë, ndërsa u dëbuan duke i spastruar etnikisht ato hapësira mbi 300 000 shqiptarë. Kjo metodë e spastrimit etnik është ndjekur në vazhdimësi ndaj shqiptarëve. Vetëm gjatë "Masakrës së vjeshtës" të vitit 1912, sipas një raporti të fshehtë të përfaqësisë austriake në Shkup, del se nga ushtria serbe janë vranë 47 000 shqiptarë. Po në periudhën 1912-1914 u dëbuan nga trevat e veta në mënyrën më çnjerëzore rreth 302 907 shqiptarë. Në vitet 1951-1966 të Jugosllavisë titiste u dëbuan nga Kosova edhe 450 821 shqiptarë. Brenda këtyre periudhave kohore, po të bëjmë një kalkulim të thjeshtë, del se nga Kosova me të gjitha viset që u shkëputën me dhunë nga trugu i saj, del se Serbia dëboi në mënyrën më barbare mbi 1 030 127 shqiptarë, të

cilëve nuk iu lejua kurrë më të kthehen në trevat dhe pasuritë e tyre. Ndërsa sa i përket gjenocidit të fundit serb në Kosovë, të cilin z. Surroi po e quan "tentim gjenocidi", gjatë Luftës Nacional Çlirimtare të organizuar nga UÇK-ja, Serbia vrau mbi 15 000 shqiptarë, mbi 90 përqind të të cilëve ishin të paarmatosur, gra, fëmijë e pleq. Po gjatë kësaj kohe janë përdhunuar mbi 20 000 femra shqiptare, janë zhdukur mbi 3 000 shqiptarë, një pjesë e të cilëve, për qëllime krejtësisht politike, edhe për së vdekuri, ende po mbahen pengë nga Serbia. Sipas një raporti të UNHCR-së të publikuar në qershor të vitit 1999, thuhet se 443 300 shqiptarë janë dëbuar me dhunë nga Kosova në drejtim të Shqipërisë, 225 000 mijë në Maqedoni, 64 mijë në Mal të Zi, 20 mijë në Bosnje, 22 mijë në Sanxhak, mbi 15 mijë në Turqi, 6 mijë në Kroaci, 3 mijë në Bullgari e shumë e shumë të tjerë në vendet të Evropës, ShBA-së, Australisë e Kanadasë, të cilët vetëm falë luftës heroike të UÇK-së dhe ndërhyrjes me kohë të faktorit ndërkombëtar mund të kthehen në vatra e veta. Gjithashtu, edhe mbi 850 mijë shqiptarë të tjerë, që mbetën në Kosovë, u detyruan të fshiheshin maleve dhe nëpër vende të tjera

për t'i shpëtuar zhdukjes së plotë fizike. Serbia nuk u ngop vetëm me vrasje dhe dëbime të shqiptarëve, por ajo shkatërroi dhe dogji mbi 1 100 vendbanime shqiptare, mbi 200 000 mijë shtëpi, lokale afariste, shkolla, monumente kulturore etj. Gjithashtu, ajo ka sekuestruar dokumentet e gjendjes civile, ka grabitur pensionet e shqiptarëve, dokumentet kadastrale etj. Këto fakte dhe shifra tregojnë se Serbia në vazhdimësi ka ushtruar dhunë e gjenocid të paparë ndonjëherë në Evropën e qytetëruar. Prandaj, z. Surroi, për t'ua bërë qejfin qarqeve të disa shteteve që tradicionalisht e mbështesin Serbinë, duke e mohuar gjenocidin, apo duke reduktuar atë në "tentim për gjenocid", jo vetëm se nuk ndihmon në zgjidhjen e çështjeve ende të pazgjidhura të Kosovës por, në fakt, ushqen edhe më shumë krizën për konflikte të mëtejshme. Besoj se z. Surroi e di mirë përkufizimin e fjalës gjenocid, që ka të bëjë me dhunën e egër, shfarosjes së plotë a po të pjesshme të një popullsie ose grupeve të vogla kombëtare që bëhen nga qeveri shoviniste. Pas të gjitha këtyre fakteve

rrëqethëse historike të pakontestueshme, të cilat kanë tronditur botën e civilizuar, ta mohosh gjenocidin serb ndaj shqiptarëve të ushtruar në vazhdimësi do të thotë të jesh me apo pa vetëdije pjesë e skenarëve të ndryshëm antishqiptarë. Ndoshta, z. Surroi do të bënte më mirë sikur në këto caste para palës serbe ta hapte çështjen e shqiptarëve të dëbuar me dhunë që nga viti 1878 e këtej. Rikthimi i shqiptarëve "Muhaxherë" në trevat dhe pasuritë e tyre, kur Serbia kërkon kthimin e të zhvendosurve në Kosovë, është më se i domosdoshëm, i drejtë dhe i pranueshëm për botën e civilizuar. Nëse një gjë e tillë për ndokënd do të dukej gjoja e pamundur, për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar, edhe pse kjo nuk qëndron, së paku të negociohet me palën serbe, që të dëbuarve t'u rikthehen apo t'u kompensohen pasuritë e grabitura nga kolonizatorët serbë. Shpresoj që fjala "tentim gjenocidi" e përdorur në fjalimin e z. Surroi në "Takimin e elefantëve" në Vjenë të jetë vetëm një lajthitje e tij e momentit dhe jo qëndrim zyrtar i "Grupit të Unitetit" (Ky shkrim është botuar në vitin 2006 në gazetën "Lajm")



# Për katër muaj në Kosovë u regjistruan 3 294 biznese

Në katërmujorin e parë të këtij viti në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve Kosovare (ARBK) janë regjistruar 3 294 biznese. Në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ky numër ka shënuar rënie për 262 biznese. "Gjatë periudhës janar - prill të këtij viti janë regjistruar 3 294 biznese, kurse në periudhën paraprake të vitit 2018 ishin të regjistruara 3 556 biznese", është thënë në përgjigjen e zyrës për informim të ARBK-së dhënë gazetës "Epoka e re". Lidhur me funksionalizmin e këtyre bizneseve, sipas një analize të Aleancës Kosovare të Biznesit (AKB), vetëm 30 për qind e bizneseve të regjistruara në Kosovë janë funksionale



**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

**PRISHTINË, 19 MAJ** - Në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve Kosovare (ARBK) gjatë katërmujorit të parë të këtij viti u regjistruan 3 294 biznese. Në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ky numër ka shënuar rënie për 262 biznese. "Gjatë periudhës janar-prill të këtij viti janë regjistruar 3 294 biznese, kurse në periudhën paraprake të vitit 2018 ishin të regjistruara 3 556 biznese. Sa iu përket numrit të bizneseve të huaja të regjistruara, kemi numër konstant të bizneseve prej 16 sosh në katërmujorin e parë të dy viteve", është thënë në përgjigjen e zyrës për informim të ARBK-së dhënë gazetës "Epoka e re". Sipas MTI-së, bizneset e regjistruara me pronarë femra në periudhën janar-prill të vitit 2019 janë 835 sosh, kurse në vitin e kaluar ishin 868 biznese të regjistruara.

Sipas kreut të Aleancës Kosovare të Biznesit (AKB), Agim Shahini, numri prej mbi 3 000 biznesesh të regjistruara

është lajm i mirë. Ai ka thënë për gazetën "Epoka e re" se vetëm 30 për qind e bizneseve të regjistruara janë funksionale. "Qytetarët e Kosovës kanë shpirt ndërmarrës dhe zgjedhin rrugën e të hyrit në biznes. Sikur të gjitha këto biznese të ishin funksionale atëherë kriza ekonomike do të ishte shumë më e vogël. Sipas të dhënave që AKB-ja ka, që nga viti 2000 jo më shumë se 30 për qind e bizneseve janë funksionale në vitin e parë. Kjo e dhënë na përsëritet në vazhdimësi. Ndërkaq kemi normë të jofunksionalizimit të tyre 25 deri në 30 për qind të bizneseve të regjistruara. Këtë vit, në muajt e fundit, kemi një rënie të regjistrimit të bizneseve për dallim nga vitet e kaluara. Kjo lidhet me krizën dhe politikën ekonomike që në Kosovë janë të shtrenjta dhe bizneset nuk mund t'i përballojnë", ka thënë Shahini, duke shtuar se në vitin e kaluar ka pasur të regjistruar 10 000 biznese.

Sipas tij, po të ishin funksionale të gjitha këto biznese Kosova nuk do ta kishte këtë papunësi. "Statistikat nuk tregojnë për

shifër të re të punësimeve. Po ashtu, nuk kishte as ndonjë korporatë të madhe e cila do t'i jepte shtytje zhvillimit ekonomik. Sa iu përket bizneseve me pronarë femra, këtu kemi një ngritje të ngadalshme të ndërgjegjes që vetë femrat tentojnë t'i hyjnë tregut të punës", është shprehur ai. Shahini ka thënë se bizneset në Kosovë përballen me sfidat e të bërit biznes, si korrupsioni, konkurrenca e pabarabartë dhe burokracia. "Një nga problemet që kanë paraqitur bizneset ishte dhe pabarazia në treg, sidomos për punët publike kur kanë të bëjnë me tenderë", ka theksuar kryetari i AKB-së, Agim Shahini. Sa iu përket investitorëve të huaj, ai ka thënë se 94 për qind e

investitorëve që vijnë në Kosovë ikin pasi legjislacioni për këtë sektor është jo i zbatueshëm. Njohësi i çështjeve ekonomike, i cili më parë ishte dhe ekspert i angazhuar nga Banka Botërore, Agim Demukaj, ka thënë se shifra prej 3 000 bizneseve të regjistruara është lajm i mirë por, sipas tij, rënia prej 262 bizneseve ka të bëjë kryesisht me rritjen e numrit të bizneseve në vitin 2018 kur ishte edhe vit i pakos fiskale. "Është lajm i mirë pasi vetëm nëse nga dy persona i punësojmë, atëherë flasim për 6 000 e më shumë të punësuar. Rritja e madhe e numrit të bizneseve të regjistruara në vitin e kaluar është në sajë të pakos fiskale. Në tërësi mund të themi se është lajm i mirë kjo shifër e

bizneseve. Por, sa janë aktive bizneset që regjistrohen, personalisht nuk kam ndonjë analizë të mirë. As Administrata Tatimore e Kosovës nuk i përcjell nga afër nëse janë aktive apo jo? Megjithatë, është lajm i mirë pasi në raport me bizneset e shuara numri i bizneseve të regjistruara është dukshëm më i lartë", u shpreh ai. Ndërkaq sa iu përket bizneseve të huaja prej 16 sosh, Demukaj ka thënë se për bizneset e huaja nevojitet kapital dhe seriozitet më i madh. "Për bizneset e huaja duhet siguri dhe kapital më i madh, gjithashtu edhe politika ekonomike të zbatueshme, prandaj merr kohë deri tek investimi i tyre", ka thënë Demukaj.

## Murtezaj: Borxhlinjtë nuk do t'i falim më



**PRISHTINË, 19 MAJ** - Ligji për Faljen e Borxheve, i cili funksionoi për dy vjet radhazi nga shtatori i vitit 2015 deri në shtator të vitit 2017, u ka mundësuar bizneseve që kishin vështirësi financiare që të përfitojnë nga ky ligj. Gjatë gjithë kësaj periudhe ATK-ja kishte falur rreth 250 milionë euro. Por, falje të tillë më nuk do të ketë.

Drejtori i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Ilir Murtezaj, në një intervistë për "Ekonomia Online" ka thënë se ligji i mëhershëm që ka mundësuar faljen e borxheve ishte efikas pasi që, krahas faljes,

inkasuan edhe borxhet e grumbulluara. Ai ka thënë se më nuk do të ketë falje për bizneset që nuk paguajnë obligimet e tyre karshi ATK-së, madje ka paralajmëruar veprime konkrete për ta zbatuar ligjin. "Mendoj se më nuk do të ndodhë falje e borxhit sepse kjo i ka të dyja anët e medaljes, pra anën pozitive dhe negative. Ana negative është sepse ne si shtet nuk jemi të njëjtë ndaj tatimpaguesve që paguajnë në bazë të rregullt detyrimet. Ndaj atyre që krijojnë vështirësi dhe nuk paguajnë me rregull po i bie sikur po u bëjmë njëfarë favor. Kështu që, ajo praktikë nuk do të ekzistojë më

nga ATK-ja, por nëse merret ndonjë vendim nga Kuvendi apo qeveria është diçka tjetër. Do të ketë veprime më konkrete nga zyrtarët e ATK-së në respektim të Ligjit dhe në mbledhjen e të gjitha detyrimeve të papaguara nga komuniteti i biznesit", ka thënë Murtezaj. Ekonomia joformale mbetet ende sfidë për ATK-në, për të cilën drejtori Murtezaj ka theksuar se po mundohen të minimizojnë, duke pranuar se çrrënjësja e saj është e pamundur. Ai ka thënë se sipas matjeve të disa organizatave ndërkombëtare, ekonomia joformale është mbi 30 për qind.



Në prag të 20-vjetorit të masakrës më ç'njerëzore në Burgun e Dubravës

# Dy dhjetëvjetëshja që nga



**Sadik ZEQRIRI,**  
ish-pjesëtar i UÇK-së,  
i mbijetuar i masakrës  
së Dubravës

Po e nis këtë rrëfim me thelbin e ngjarjes, me datën historike, ndër më të tmerrshmet në jetën dhe kujtimet e mia që kam përjetuar. Ajo nis më 14 mars 1999. Në Burgun e Pejës tashmë kisha mbajtur burg më shumë se shtatë muaj. Në kohën e darkës erdhi një gardian shqiptar që ishte në ndërërim, na dha bukë dhe më tha se, ndoshta, nesër do t'ju transferojnë në Dubravë. Unë u stepa ashtu si isha, në këmbë. Fillimisht mendova se është më mirë të na transferojnë atje sepse të burgosurit kur i lëviznin për burgje të tjera dhe kur ndonjë e sillnin prapë në Pejë, thoshin se në Dubravë ka kushte më të mira dhe se atje edhe hapësira më e madhe ta lehtëson më shumë qëndrimin në burg. Në anën tjetër nuk kisha dëshirë të më largonin nga Burgu i Pejës sepse aty familja ime (nëna dhe të tjerët) e kishin më lehtë të më vizitonin sepse e kishin më afër nga shtëpia. Pasi hëngrëm darkë, kah ora 21:00 e natës së 14 marsit u fikën dritat dhe na lajmëruan, si çdo natë tjetër, të binim në gjumë. Në dhomën numër 4 të pavijonit të tretë në Pejë ishim gjashtë të burgosur. Pesë ishim shqiptarë, njëri ishte serb.

Kohën e fundit kisha shumë probleme me gjumë. Nuk më merrte fare. Pothuajse gjithë natën mendoja, për gjithfarë, po në fund asnjë zgjidhje s'bëja. Kështu, me dërrmim, e kalova edhe natën e fundit në Burgun e Pejës. Më datë 15 mars 1999 ishte afuar të çelte agu e unë ende rrija zgjuar. Kështu si unë, pa vënë gjumë në sy, ishte edhe ish i burgosur i nacionalitetit serb që e kisha në dhomë. E pyeta bashkëvuajtësin pse nuk po flinte ende? Ai më tha: "Sadik, sot kanë me ju transferu në Dubravë, aty kanë me i tubu të gjithë të burgosurit nga të gjitha burgjet, ju çka jeni shqiptarë, e prej aty pritret, nëse përfundon lufta, juve me ju leshu grumbull nga burgu". Pas pak minutash u ndezën dritat. Dyert e dhomave filluan të hapen një nga një. E hapën edhe derën e dhomës sonë dhe hynë brenda dy gardianë, me një listë në dorë dhe thirrën emrin tim dhe më thanë: "Sadik Zeqiri, ke kohë pesë minuta të përgatitesh. Po transferohesh në Dubravë". Të njëjtin lajmërim ua dhanë edhe disa të burgosurve të tjerë. I përgatitëm plaçkat dhe u

rreshtuam në korridorin e ngushtë. Na futën në furgonë të policisë dhe na nisën për Dubravë. Kur na zbankuan atje, na shpërndanë nëpër pavijone të ndryshme, por shumicën prej nesh na dërguan në pavijonin C. Në këtë pavijon pothuajse shumica e të mbajturve ishin me aktakuza të ngritura dhe që pritej të dënoheshim me shumë vite burg. Mua më caktuan në dhomën nr. 35, në katin e dytë, me dritare kah fusha e sportit, e cila më vonë u bë fusha e gjakut. Aty na vendosën katër të burgosur që na sollën nga Peja. Në dhomë e gjetëm një të burgosur që kishte kohë që ishte aty. Edhe ai ishte pjesëtar i UÇK-së. Aty u bëmë pesë veta. Shoqëri e re, bisedë e re. Kishim çfarë të flisnim. Në dhomë ishim të gjithë shqiptarë. Dritaret e dhomës sonë në burg ishin të mëdha. Na kishte marrë malli ta shihnim natyrën, malin e fushën. Ne në këtë pavijon s'e patëm fatin e pavijoneve të tjera sepse të burgosurit që ishin në pavijone të tjera u ushqeheshin në kuzhinën e burgut, pastaj dilnin në shtëpitë sipas orarit, ndërsa neve të C-së na sillnin ushqimin në dhomë.

Ditët ecnin e ne prisnim të liroheshim sepse ashtu na vinin informatat, sepse na patën thënë se nëse deri më 24 mars 1999 nuk pajtohet Serbia ta ndalë luftën, atëherë do të intervenonte NATO dhe do t'i fillonte bombardimet. Në natën e 24 marsit ne, po jo vetëm ne që ishim të burgosur por, mbase, të gjithë shqiptarët kanë qëndruar zgjuar duke pritur fillimin e bombardimeve në caqet serbe. Oshtimat e avionëve, bombardimet e tyre mbi makinerinë serbe, i dëgjua edhe ne në burg. E ndienim që brenda lirinë, po edhe vdekjen. Bombardimet vazhdonin dhe shtoheshin ditë ditë. I dëgjonim edhe gjuajtjet në Pejë. Gjatë kësaj kohe të bombardimeve filluan të mbushen pavijonet edhe me më shumë të burgosur. Aty sillleshin pothuajse çdo ditë njerëz. Ardhjet e tyre i shihnin nga dritaret e burgut, sepse nga pavijoni C shihnim edhe derën kryesore të hyrjes. Ne nuk dinim kush janë ata si dhe as nga vinin. Po gjatë kësaj kohe edhe sjelljet e gardianëve ndaj nesh ndryshuan shumë. U bënë shumë të vrazhdë. Filluan të na rrahin për ditë. Rrahjet dhe maltretimet i fillonin në dhomat e izolimit, aty ku ishin të vendosur vëllezërit Kida, e i vazhdonin deri në dhomën e fundit. Ndihehim keq kur dëgjonim ofshamat e të rrahurve, po ndiheshim shumë më mirë kur edhe neve na vinte rendi i rrahjes, sepse e kryenim "fruthin", siç i thoshim në burg.

Disa të burgosur shqiptarë që na sillnin ushqimin nëpër dhoma e të cilët ishin të dënuar për vepra ordinere, kohë pas kohe na

njoftonin se nga vinin të burgosurit. Ata na treguan se më 29 dhe 30 prill i kanë sjellë të gjithë të burgosurit shqiptarë që kanë qenë nëpër burgjet e Serbisë (burgu i Mitrovicës së Sremit, Burgu i Nishit etj.) dhe i kanë vendosur në pavijonin B. Kur i nxirrnin për të ngrënë ushqim në kuzhinë këta të pavijonit B, ne dilnim në dritare që t'i shihnim sepse e dinim se aty ishin grupet e mëdha të të arrestuarve e të dënuarve si nismëtarë të UÇK-së, siç ishin Nait Hasani dhe Arif Vokshi me grupin e tyre të UÇK-së, grupi i LKÇK-së në krye me Avni Klinakun, pastaj ish-gupet e sindikatave të Policisë së Kosovës, Avdi Mehmeti, Sheremet Ahmeti etj., Bajrush Xhemajli, Ukshin Hoti, Hajredin Hyseni, Raif Qela etj., pastaj grupi i ushtarëve të rastit të "Paraqinit", Rasim Selmanaj, Besim Rama, djemtë e Unionit të Studentëve të Prizrenit etj. Unë i njihja shumicën prej tyre. Disa i kisha shokë të fakultetit, disa të tjerë i njihja për veprimtarinë e tyre, e për disa kisha dëgjuar dhe lexuar që e gjithë jeta u kishte shkuar duke u marrë me veprimtari patriotike e duke u arrestuar e liru nga kazamatet serbe.

Më 16 maj 1999, në paraditen e ditës së diel, një njeri shoqërohej nga disa gardianë për te dera e daljes së burgut. Nuk e dinim kush ishte sepse kishte një distancë ndërmjet tij dhe nesh, por u gëzua që dikush ose po lirohet, ose po i ndërrohet burgu. Më vonë kuptuam se ai njeri shtatë, me një ecje vertikale, kishte qenë profesor Ukshin Hoti. Pas pak minutash e liruam edhe një të burgosur tjetër nga pavijoni ynë. Atë e njohtë. Ishte nga Juniku, me mbiemrin Pepshi. Edhe atë e nisën kah dalja kryesore. Më kujtohet shumë mirë kur e dëgjua të sapoliruarin që e pyeti gardianin: "Sot është e diel. Deri ku keni mem dërgu?" Gardiani i tha do të përcjellim deri në Pejë, më pas shko kah të duash. Këtë bisedë e kemi dëgjuar nga dritaret që i kishim hapur. Nga kjo bisedë kuptuam se ai i burgosuri tjetër nuk qenka transferuar, por qenka liru. Eshtrat e Pepshit janë gjetur dhe identifikuar në vitin 2005 diku në varrezat e rrethit të Pejës.

Më datën 18 maj 1999, në hapësirat e Burgut të Dubravës, e sjellin edhe një kontingjent të madh të njerëzve. Edhe pse i kishim larg, vëreheshin se ishin të veshur me tesha civile, disa edhe kishin flokë të gjatë. Sipas mendimeve tona, ata ishin zënë pengje. Ata i vendosën në një objekt që kishte qenë dhe ishte shfrytëzuar për shkollë. Më vonë kuptuam se ata ishin një grup i madh prej 150 vetash të zënë robër nga qyteti i Gjakovës. Gjatë këtyre ditëve të bombardimeve të NATO-s na i linin dritaret hapur për të shikuar dhe



dëgjuar atë çka kishim hapësirë dhe mundësi. Një ditë vjen një nga gardianët që ishte në ndërrim dhe i hap dyert e dhomës sonë. Ai nga jashtë kishte veneruar se ne po shikonim në dritare. Kur e hapi derën, na zuri neve duke shikuar nga dritarja. Gardiani ishte ose nga rrethina e Istogut ose e Pejës sepse e njihje gjuhën shqipe dhe nganjëherë fliste edhe shqip. Pasi na zuri në këmbë na tha afrohu me afër dritareve t'ju tregoj kush janë këta fshatra. Ndër ta e përmendi edhe Shushicën dhe tha se, përpos disa ushtarë që kanë mbetur në male lart dhe juve në këtë burg, asnjë shqiptar nuk ka mbetur në Kosovë. Të gjithë i kemi vrarë dhe ata që kanë mbetur gjallë i kemi dëbuar nga Kosova. Gardiani ishte i gjatë, i ri dhe kishte flokë të bardha. Për dallim nga kolegët e tij, ky ishte më i butë dhe reagimet e tij kishin një kufi veprimi. Ne në pavijonin tonë që ishim e kemi pasur të pamundur t'ua mësonim emrat gardianëve përpos që përmes fytyrës dhe ecjes së tyre i mbanin në mend. Për shembull, në dhomën tonë i patëm pagëzuar me emra të ndryshëm disa prej tyre dhe me këta emra i njihnin edhe të tjerë sipas veprimeve që bënin. Njërin e quanim "sakica" sepse, sapo merrte ndërrimin, fillonte rrahjet e të burgosurve që nga dhoma e parë e deri në të fundit. Edhe gardiani me flokë të bardha një ditë e kaloi kufirin e butësisë sepse na detyroi të laheshim me ujë të ftohtë. Gjatë kohës sa kemi qenë në burg uji për t'u pastruar lëshohej nga jashtë, ndërsa ne pastroheshim brenda dhe përgatitjen e ujit e bënin vetë gardianët. Një ditë ishte shumë ftohtë. Na thanë që të shkojmë për t'i prerë flokët.

Kishin kaluar nja katër muaj pa i prerë flokët dhe ishim bërë si për gjynah të Zotit. Një djalë që e gjetëm në dhomë na tregoi se, pasi po na dërgojnë që t'i presim flokët, brenda mundësive të kalojë në rendin ku një prej dy "bricave" është shqiptar. Na bënë rresht dhe na dërguan në pjesën tjetër të pavijonit, te dy berberët. Unë herë dilja në njërin rend, herë në tjetrin, që të shoh cili është shqiptari. Shqiptari m'u duk ai që ishte më zeshkan se tjetri. Por ia kisha huq. Atë ditë që të dy berberët kishin qenë serbë. Kur filloi të më qethë berberi e falënderova dhe i thashë se po bën mirë sepse, ndoshta, po na lëshojnë këto ditë. Sapo thashë këtë fjalë më mësoi me makinë në kokë, me gjithë fuqinë që kishte dhe më shau. Pasi na prenë flokët na dërguan në dhoma, pastaj na thanë të zhvishemi për t'u pastruar. U zhvishëm të gjithë në dhomë dhe u afuam aty ku kishte ujë. Gardianët, një ndër ta edhe ky djaloshi me flokë të bardha, na lëshoi ujë të ftohtë dhe na detyruan të laheshim ashtu dhe të mërdhisheshim.

Në mëngjesin e datës 19 maj kishim hapur dritaret t'i shihnim luftimet që bëheshin në disa fshatra aty në malet e Istogut. Aty shiheshin edhe forcat serbe që hynin në fshat dhe digjin shtëpitë, merrnin bagëtinë si dhe traktorët dhe veturat. Në atë çast një zhurmë e madhe u dëgjua në afërsi tonën. Aeroplanët e NATO-s kishin qëlluar ngrohtoren e burgut si dhe drejtorinë e saj. U dëgjua një britmë e madhe. Filluam edhe më me interesim të shikojmë se çfarë po ndodhte dhe pamë se gardianët filluan të ikin në drejtim të derës kryesore të burgut. Pas pak minu-



# krimi i pandëshkuar



tash aeroplani i NATO-s goditi edhe pavijonin tonë, C-në. Goditja ndodhi në mesin e saj dhe, fatkeqësisht, mori jetën e tre të burgosurve shqiptarë dhe plagosi shumë të tjerë. Ne që qëlluan afër dritares shpëtuan, por nisëm të kërkojmë ndihmë që të na hapin dyert. Por, kërkesa jonë nuk shkonte më larg se në dhomën tonë. Askush s'kishte mundësi as të na dëgjonte e as të na ndihmonte. Filluam të mendonin se si ta hapnim derën. E shkatërruam një shtrat në dhomë dhe filluam ta godasim derën. Muret ishin plasaritur nga detonimi. Bëheshim dy nga dy sepse nuk kishim fuqi dhe as vend të godisnim të gjithë përmjetherësh. Ishim të gjithë nga 50 apo 60 kilogramë, jo më shumë. Të gjithë kishim rënë në peshë sepse na shërbenin për të ngrënë pak, vetëm një kulaç të vogël që, besoj, nuk i kishte 100 gramë. Një nga të burgosurit e dhomës, Shkumbini nga Strellci, vërejtë nga dritarja se shumë të burgosur kanë nisur të na vijnë në ndihmë me mjete pune. Duke ndier gëzim, e demoluam derën e dhomës, e thyem dhe e hapëm. Kur dolëm jashtë pamë të burgosurit e pavijoneve të tjera duke ua hapur dyert të burgosurve. I pamë duke i bartur të plagosurit dhe duke i nxjerrë nga gërmadhat e dhomës të vrarët ku kishte goditur NATO.

Dolëm në oborr dhe u tubuam shumica e të burgosurve dhe u nisëm për te dera e daljes. Aty na dolën gardianët përpara dhe nuk na lanë të vazhdojmë tutje. Tani frika kishte depërtuar deri në palcë. Nuk dinim ç'të bënim. Situata brenda Burgut të Dubravës kishte dalë jashtë çdo kontrolli. Gjatë kësaj dite, e cila as

vetë nuk e di se sa ka zgjatur, ia kemi dalë disi që të shpëtojmë. Forcat e NATO-s atë ditë më nuk kanë gjuajtur në brendësi të objektit të burgut. Edhe më 20 maj ka qenë qetë dhe kemi fjetur siç kemi mundur në pavijonet e padëmtuar. Më 21 maj prapë forcat e NATO-s kanë sulmuar pavijonet e Burgut të Dubravës si dhe rrjetin e ujësjellësit dhe, me siguri, edhe bazën e centrales telefonike. Pothuajse ishin dëmtuar të gjitha objektet. Në natën e datës 21, në të hyrë të datës 22 maj, kemi fjetur jashtë. Shumica te fusha e sportit, dikush me batanije e dikush i pambuluar, na ka çel mëngjesi i datës 22 maj 1999. Nga pikat vrojtuese që ishin aty afër, në mëngjesin e datës 22 maj na kanë urdhëruar të rreshtohemi për të na dhënë një lajm me rëndësi. Unë kam qenë afër me Rasim Selmanin. I kam thënë po marr pak ujë në shishe e po i pastrojmë sytë. Ujë kishim mjaft sepse ishte goditur tubi kryesor nga raketat dhe ishte bërë aty si pishinë. Rasimi më priti, i pastruam sytë dhe u ndamë. Derisa hyra në rresht, veç i pashë të burgosurit duke u rrëzuar përtokë. Ngrija kokën të shikoj se çka po ndodh sepse, në njëfarë forme, të gjithë ishim të mpirë dhe nuk dinim nga po vinin plumbat kur, më në fund, pashë nga pikat e vrojtimit duke hedhur bomba mbi ne, duke gjuajtur me armë etj. Mund të them lirisht se kush ka qenë në rendin e parë është vrarë nga gardianët dhe uniformat e tjera serbe që ishin të stacionuara përreth Burgut të Dubravës. Militarët dhe uniformat serbe si dhe detonimet e NATO-s kishin hapur pjesë të murit e që, për fat të keq, disa të burgosur kishin rënë pre e idesë

për t'u arratisur. Këtë fat e kanë përjetuar mbi 20 të burgosur kur një nga të burgosurit, i cili nuk ishte në burg si pjesëtar i UÇK-së, por për vepra të tjera i kishte mbledhur disa të burguar dhe u kishte thënë se unë mund t'ju nxjerrë nga burgu. Ata kishin vepruar sipas idesë së tij dhe ishin larguar. Ne kemi menduar se ata kanë shpëtuar, por më 24 maj, kur na transferuan për në burgjet e tjera, respektivisht për Lipjan, ata të gjithë të burgosurit i kishin zënë e i kishin vrarë dhe i kishin tubuar afër portës kryesore. Aty kanë qenë grumbull të vrarë diku 16 të burgosur. Pasi ne tanimë nuk dinim se nga po vijnë gjuajtjet dhe nuk dinim ku të fshiheshim, sepse ishim shumë të ekspozuar në një fushë sporti, filluam të ikim deri në një pjesë ku mundeshim të fshihemi përkohësisht, më pas me vrap të afrohem rreth objekteve. Edhe gjatë ikjes shumë nga ne janë plagosur e vrarë nga armët dhe nga bombat që i hidhnin gardianët e policët serbë. Pas një kohe kanë pushuar gjuajtjet dhe kemi filluar të dalim nga aty ku ishim fshehur për t'i kërkuar të afërmit dhe të tjerët. Po ashtu, edhe për t'iu ofruar ndihmë mjekësore atyre që ishin plagosur. Këtu merita të jashtëzakonshme kanë shumë të burgosur të cilët iu kishin afruar ndihmë të plagosurve. Gjatë kësaj dite pandërprejë ka pasur gjuajtje nga të gjitha anët e burgut. Ne ishim të rrethuar dhe shumë pak kishim mundësi të fshiheshim. Kishim shumë pak vende të paekspozuara, sepse çdo kund të gjuante snajperisti. Ne një grup ishim të fshehur pas një grumbulli drush që ishin afër kuzhinës, dhe afër neve njërin nga ne e rroku një snajper në kokë, ia çau kokën dhe truri i doli jashtë. I burgosuri ende ishte gjallë dhe i lëvizte këmbë e duar, por në ato çaste erdh Bislim Zogaj, një hero i vërtetë i kësaj kohe, që me duar ia ka afruar pjesët e kokës. Kishte filluar të errësohet dhe ne nuk dinim kah t'ia mbanim, as ku të flinim e as ku të fshiheshim. Të burgosurit e vjetër, të cilët kishin më shumë përvojë dhe ishin edhe më të moshuar se ne, kishin tubuar të plagosurit dhe ua kishin dhënë edhe ndihmë e parë me mundësitë që kishin. Një grup i të burgosurve, në krye me Dëfrim Rifajn, kishte depërtuar nëpër plumba deri në ambulancën që ishte brenda mureve të burgut dhe kishte marrë aty çfarë kishte gjetur. Më pas, me këto mjete sanitare, shumë të plagosurve u është shpëtuar jeta. Ndërsa shumë nga ta edhe kanë vdekur nga pamundësitë teknike. Edhe unë isha plagosur në atë ditë në fushën e sportit dhe Dëfrimi me shokë ma lidhën plagën me një fashë veç sa për ta ndaluar gjakun. Sot e atë ditë ende e mbaj pjesën e plumbit serb

të futur brenda në trupin tim më 22 maj 1999. Kur jam liruar nga burgu e kam vizituar mjekun për këtë çështje dhe, pas fotografimit, më ka thënë se një herë qenke jo mirë me shëndet e kur të trashesh pak ta heqim sepse edhe ashtu tash rreth pjesës së plumbit është tubuar shtresë dhjamore dhe nuk do të kesh telashe. Kurrë më nuk kam shkuar te mjeku për këtë çështje. Do ta mbaj atë plumb në bark aq sa më ka dhënë Zoti jetë. Pasi u errësua, një vendës imi më njoftoi se te ngrohtorja, në bodrum, e kishin përgatitur vendin për të fjetur dhe kishin futur edhe sfungjerë aty dhe, sipas tij, vendi është i sigurt. Shkova te ta, por s'i gjeja edhe dy bashkëshatarët e mi. Pasi e takova Gzimin dhe i tregova që mund të shkojmë të flemë atje sepse ishte vend i sigurt, ai më tha më mirë po shkojmë te kuzhina sepse aty kanë shkuar mbi 600 të burgosur të tjerë dhe është më mirë të rrimë aty bashkë. Ndërkohë e takoj edhe një shok timin të fakultetit, Demirin, i cili ishte arrestuar me grupin e Nait Hasanit. Edhe Demiri më thotë të shkoj me të te pavijoni C, aty ku ishin mbledhur këta bashkë me të plagosurit. Edhe Enverin e takova dhe u gëzova shumë që ishte gjallë. Bile e pyeta a je ti vëllai i Bujarit? Ai me shaka më tha Bujari është vëllai im. E dëgjova Gzimin dhe shkuam te kuzhina. Për fat të keq të atyre bashkëvuajtësve të mi të cilët kishin shkuar për të fjetur në bodrumin e ngrohtores, pothuajse të gjithë kur kanë hyrë në mëngjes paramilitarët i kanë vrarë në gjumë, përpos dy a tre të burgosurve të cilët kanë hyrë nëpër gypat e nxehtësis dhe kanë shpëtuar pa u hetuar. Mëngjesi i datës 23 maj na ka çel me gjuajtje të bombave dhe të armëve nga paramilitarët serbë të cilët kishin hyrë brenda burgut. Ata kishin disa shirita të kuq në krahë, disa shirita të gjelbër e disa edhe të verdhë si dhe ish të burgosurit serbë të cilët tanimë ishin armatosur dhe luanin rolin e vrasësve. Shumë të burgosur ishin fshehur nëpër pusete në oborrin e burgut. Ata kaluan më së keqi në këtë ditë të 23 majit, sepse ushtria, policia e paramilitarët i hapnin kapakët e puseteve dhe i vritnin aty brenda, pastaj u gjuanin edhe bomba etj. Neve na kishin rrethuar kuzhinën komplet dhe gjuanin në muret e saj dhe na kërkonin me megafon të dilnim jashtë. Askush nuk merrte guximin të dilte i pari. Megjithatë, një burrë, rreth të 50-tave, nga Gjakova, që më vonë mora vesh se ishte Mehdi Ferizi, doli jashtë me duar pas koke. E urdhëruan bacën Mehdi të na lajmërojnë neve për herë të fundit që të dalim jashtë. Dolëm edhe ne, me duar të lidhura pas koke dhe u rreshtuam të gjithë. Para nesh qëndronin komandanti i burgut,

disa gardianë dhe disa të tjerë në uniformë, por me shirita të kuqe në krahë, të gjithë të armatosur, me armët drejtuar kah ne. Të gjithë menduam se aty tashmë përfundoi çdo gjë, jeta jonë dhe veç pritnim të na vritnin. Filluam të përsëndetemi mes vete dhe t'ia marrim hallallin shoqi-shoqit. Afër nesh kishte edhe disa bure të mbushura me benzinë. Na thanë të nisemi dy nga dy në drejtim të sallës së sportit. Na tubuan të gjithëve në sallë, disave u thanë të shkojnë t'i thirrën të gjithë kush janë të fshehur dhe, po ashtu, t'i mbledhin edhe të plagosurit e t'i sjellin në sallë. Derisa u tubuam të gjithë, pothuajse gjithë kohën një i uniformuar qëndronte te dera me një zollë në krahë në drejtimin tonë.

Pasi u tubuam pothuajse të gjithë, na u kumtua lajmi se, pasi që nuk ka kushte dhe siguri në hapësirat e Burgut të Dubravës, nesër në mëngjes, më 24 maj, do të na transferojnë për në burgjet e tjera. Të nesërmen ndodhi edhe transferimi ynë për në Burgun e Lipjanit, transferim që u bë me autobusë dhe me kamionë (në kamionë i kanë vendosur të plagosurit). Pas nesh, të vrarë në hapësirat e Dubravës, lamë mbi 130 veta. Nga Lipjani, në mëngjesin e hershëm të datës 11 qershor 1999, na nisën për në burgjet e Serbisë (mua në Nish bashkë me 600 të burgosur të tjerë), të tjerët në Pozharevc, Mitrovicë të Sremit, Leskovac, Vranje, Beograd etj., deri në lirim tonë përfundimtar dhe kthimin në Kosovë.

Në Kosovë kanë ndodhur shumë masakra, siç është ajo e Mejës, e Krushës, e Poklekut, e Studimes, e Suharekës, e Qyshkut, e Reçakut, e Abrisë, e shumë vrasje dhe gjithsecila e ka historinë e vet, por masakra e Dubravës ndaj të burgosurve, një pjesë e të cilëve edhe ishin të dënuar, të tjerët priteshin të dënoheshin dhe të tjerët që ishin të burgosur për vepra të ndryshme jopolitike, patën fatin e njëjtë të vrasjes, edhe pse ishin nën juridiksionin e Ministrisë së Drejtësisë dhe asaj të Punëve të Brendshme të Serbisë. Pra, masakra në Dubravë është organizim shtetëror dhe pak ka rëndësi vrasësi. Për këtë masakër është dashur dhe duhet të japë përgjegjësi shteti i Serbisë dhe të dënohet për gjenocid ndaj njerëzimit. Duhet që për këtë masakër të organizuar, pas dënim-it për gjenocid, Serbisë t'i ndalohej të udhëheqë, në një afat prej 50 vjetësh, ndonjë institucion evropian apo botëror, duhet të jetë e suprimuar edhe në të drejtat e pjesëmarrjes në ngjarje sportive etj. Themelimi i gjykatës ndërkom-betare për krimet serbe në Kosovë, që tani ka lindur si ide, do të kishte qenë mirë të jetësohej sa më parë e jo të mbetet vetëm ide.



Bisedë me humanistin, biznesmenin dhe atdhetarin, shqiptaro-amerikanin Mhill Gjuraj

# Jeta, biznesi dhe sukseset në Amerikë

Lumturije BEKAJ

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës shqiptarët kanë treguar suksese të jashtëzakonshme, pasi me punën dhe angazhimin e tyre dallohen nga komunitetet e tjera dhe kjo tregon se, pavarësisht ku jetojnë dhe veprojnë, dashuria e madhe për vendin e origjinës mbetet e pazëvendësueshme për shumë shqiptarë që jetojnë në "tokën e premtuar" apo përtej Oqeanit Atlantik.

Shqiptarët në këtë vend kanë arritur shumë suksese në shumë fusha, por sektori i patundshmërive është ai që shqiptarët i bënë më të dalluar se komunitetet e tjera që jetojnë në Amerikë. Jo rrallëherë thuhet se njerëzit e biznesit dhe të dijes janë dy shtylla të zhvillimit të kombit. Andaj, jeta dhe veprimtaria e shquar atdhetare, humanitare, fetare dhe sukseset në biznes kanë bërë që Mhill Gjuraj të jetë një shembull i mirë që duhet ndjekur çdo shqiptar kudo që ndodhet. Si i tillë ky shqiptar i suksesshëm është figurë model për gjeneratat e reja se si ndershëm, me punë, mund e djersë, mund të kontribuosh jo vetëm për vete, por edhe në tabanin kombëtar si aktivist i palodhur i çështjes shqiptare.

Mhill Gjuraj njihet në komunitetin shqiptar në Amerikë si njeri fisnik me shpirt njerëzor,

thjeshtë, njeri i aksionit dhe i sfidave, duke e ruajtur dinjitetin e shembujve të ndritshëm të atdhetarëve të kohës. Mhill Gjuraj është mbështetës i madh i lëvizjeve nacionale kudo në Amerikë, përfshirë edhe Fondin e Qeverisë së Kosovës e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kontribuues i jashtëzakonshëm financiar në fondin e trepërqindëshit dhe të atij "Vendlindja thërret", për t'i dalë në ndihmë vendlindjes së tij dhe popullit shqiptar në atë kohë kur Kosova ishte e robëruar dhe e shumëvujtur.

## Kush është Mhill Gjuraj?

Me origjinë nga Iballja e Pukës, që nga viti 1887 i përndjekur nga turqit, u shpërngul në Kosovë për t'i humbur gjurmët e përndjekjes. Për këtë shkak ndërroi mbiemrin nga "Noka" në "Gjuraj" dhe qysh atëherë mban këtë mbiemër. Megjithatë, nuk është mbiemri vetëm ai që të cilëson patriot, por veprimtaria e tij atdhetare ndaj Kosovës.

Humanizmi dhe atdhedashuria kanë bërë që familja Gjuraj të jetë e përndjekur vazhdimisht nga pushtimi serb, ku edhe jeta e tyre u bë e vështirë, andaj kjo familje vendosi ta marrë rrugën e migrimit.

Në vitin 1972 Mhill Gjuraj bashkë me familje u largua nga Kosova drejt Italisë, fillimisht bashkë me babanë, nënën dhe



katër vjet, dhe më pas kishte blerë një shtëpi të cilën e riparoi dhe më vonë e shiti me një çmim të dyfishtë. Nga ky moment filloi të merret me këtë biznes me patundshmëri. Gjuraj ka thënë se me shumë sukses arriti këtu ku është, si një ndër biznesmenët më të suksesshëm në Nju Jork. Më tutje, Gjuraj tregon se me bashkëshorten e tij, Agën, kanë katër fëmijë: dy djem dhe dy vajza.

Vajza e madhe quhet Linda, e cila mbaroi kolegjin dhe punoi ca kohë sekretare avokati, ndërsa tani ajo punon në zyrë me të atin, ku punojnë bashkë në biznesin e tij, kurse vajza e dytë është mësuese, ndërsa djali i madh Zefi punon për shtetin në Nju Jork si super revizor, kurse djali i dytë punon në Manhattan për një kompani rrobash italiane, i cili shkon në Itali, Francë e gjithandej në funksion të biznesit të kompanisë.

## Kontributi i Mhill Gjurajt në aktivitetet e shumta kombëtare dhe fetare

Vlen të theksohet se Gjuraj njihet si njëri ndër kontribuuesit e dalluar të komunitetit shqiptaro-amerikan për çështje të ndryshme kombëtare dhe fetare. Për këtë çështje ai thotë se kur kontribuoi për aktivitetet kombëtare apo fetare nuk ka pasur asnjë qëllim përftimi por, thjesht, e ka ndër obligim që të

kontribuojë në shërbim të shoqërisë. "Populli ynë e ka pasur traditë ndihmën ndaj njëri-tjetrit. Nëse të gjithë do të japim nga pak nga trasta jonë e bukës, siç bënë të parët tanë, sigurisht tani janë mundësitë më të mëdha këtu në Amerikë. Vërtet shumë gjëra do të jenë më në rregull. Dhënia e këtyre kontributeve është thjesht dëshirë dhe kënaqësi për të ndihmuar, për të bërë diçka që i shërben komunitetit, shoqërisë dhe kombit", ka thënë ai.

Në mënyrë modeste Gjuraj ka përmendur vetëm një pjesë të kontributit të tij për çështjet fetare, duke përmendur kështu një sponsorizim prej 8 000 dollarësh në fillimin e punimeve, kurse shumën prej 20 000 dollarësh në vazhdim të këtyre punimeve, pikërisht për një dritare në emrin Mhill Gjuraj për Katedralen e Prishtinës.

Ai tregon se për shtatoren "Nënë Tereza" në Pejë, të cilën e ka ndërtuar me vetiniciativë, ka investuar mjete të veta vetjake në shumën prej 100 mijë dollarësh, po ashtu ka ndihmuar Katedralen e Tivarit dhe të Malit të Zi, përmbajtjet në Shkodër, kishën "Lady of Shkodra" në Nju Jork etj.

Krahas këtyre kontributeve ai ka qenë i pandalshëm edhe në kontributet dhe ndihmën që është kërkuar sidomos gjatë dekadës 1990-2000 e më tutje për çështjen e Kosovës, njëherësh ka ndihmuar shumë familje në nevojë, shoqata të

ndryshme në Amerikë, si dhe ka organizuar aktivitete me përmbajtje kombëtare. "Vërtet këto kontribute janë simbolike, por të dhëna me shumë dëshirë e vullnet, e të cilat më kanë sjellë kënaqësi të madhe. Pse ta fshehu një gjë. Më kanë sjellë mbarësi në biznes", ka thënë Gjuraj, i cili gëzon një biznes të suksesshëm.

## Kthimi në Kosovë pas 25 vjetësh

Ai në këtë bisedë ka treguar se më 07.04.1997, pas 25 vjetësh, bashkë me bashkëshorten dhe fëmijët, vendosën ta vizitojnë Kosovën edhe pse situata ishte jo e mirë. Për shkak të situatës në Kosovë dhe mungesës së linjave ajrore nga Amerika për në Kosovë, ai kishte vendosur që udhëtimin ta bëjë në linjën Nju Jork-Beograd-Kosovë.

Tregimin e tij shqiptaro-amerikani Mhill Gjuraj e nis me arritjen në Aeroportin e Beogradit, ku edhe filluan vështirësitë, maltretimet dhe problemet, pasi që ai nuk dinte asnjë fjalë serbisht. "Kur zbritëm në Aeroportin e Beogradit, duke pritur bagazhin, fëmijët po më pyesin se ku është tualeti. Unë fillova të shikoj rrotull se ku janë tualetet. Duke kërkuar, vërejtja se një person po më sillet herë para e herë pas, e që më vonë e kuptova se ishte detektiv. Po më pyet në gjuhën serbe: 'Shok, çka po shikon ashtu?' Unë s'bë-



biznesmen i suksesshëm, pjesëmarrës i shumë protestave antiserbe të organizuara në qendrat më të njohura të Amerikës. Mhill Gjuraj është atdhetar i Kosovës dhe i çështjes shqiptare në përgjithësi. Ai dallohet si veprimtar i shquar dhe humanist i komunitetit shqiptar në Amerikë, i cili e tregoi veten në kohën kur atdheu i tij, Kosova, ishte shkatërruar nga okupatori serb. Njeri i edukuar me frymën e pagëzimit kombëtar, misionar i

shtatë fëmijët e tyre dhe qëndruan për rreth 16 muaj. Pasi u pajisën me dokumente italiane, në nëntor të vitit 1973 emigruan drejt Amerikës dhe në fillim u vendosën në Bronx të Nju Jorkut, ku qëndruan një kohë dhe më pas u vendosën në Stamford Connecticut, ku aty filloi punën në një restorant italian.

Ai për gazetën "Epoka e re" ka treguar se pasi nuk fitonte shumë para, filloi edhe një punë të dytë, në të cilën punoi



# të shqiptaro-amerikanit Mhill Gjuraraj



Më të arritur në Gjakovë, Gjuraraj vazhdon tregimin, se pas dy ditëve i është dashur të shkojë të lajmërohet tek organet e rendit, nën masat e dhunshme, për ta lajmëruar familjen se sa do të qëndrojë në Kosovë. "Më të hyrë në zyrë një zyrtar m'i kërkoi të gjitha pasaportat amerikane. Ai m'u drejtua në gjuhën shqipe, edhe pse ai ishte serb. Më tha: 'A po e sheh hartën në mur?' I thashë po. Ia nisi duke i përmendur të gjitha shtetet, duke filluar nga Rumania, Bullgaria, Greqia, Shqipëria, Kroacia, Sllovenia, Ulqini dhe të gjitha me radhë. Në fund më tha: 'I ke tre muaj kohë të qëndrosh në Kosovë dhe në Jugosllavi ku të duash'. Unë i thashë vetëm dhjetë ditë do të qëndroj këtu, disa ditë në Ulqin, pastaj do të kthehem në Amerikë", ka shpjeguar Gjuraraj. Gjatë qëndrimit në Gjakovë ai një ditë vendos që të shëtisë nëpër këtë qytet, pasi që kishte kohë pa e vizituar. Ai tregon se me të dalë në qytet i është kujtuar Gjakova e viteve të '70-ta. Më tutje, ai tregon se atë ditë e tërë rruga ishte mbushur me specat, domate, patate dhe gjëra të tjera, ku shiheshin edhe policët serbë. Pas dhjetë ditëve të qëndrimit në Kosovë, ai vendos ta vizitojë Ulqinin për disa javë dhe pas këtyre javëve vjen koha e kthimit për në Amerikë. Megjithatë, ai ka treguar edhe një përvojë të hidhur të rrugëtimit të tij nga Ulqini deri në Beograd, pikërisht në aeroport. "Pas Ulqinit mora rrugën e kthimit për në Amerikë. Rrugës për në Beograd, pikërisht në kufirin me Malin e Zi, në orën 19:00 të mbrëmjes u afruan tre policë serbë te vetura jonë dhe na pyetën se ku jemi duke shkuar, përderisa shoferi i tha

se në Aeroportin e Beogradit. M'i kërkuan pasaportat, por nuk dinin t'i lexonin pasi ato ishin pasaporta amerikane, por në ndërkohë thanë mes vete se këta qenkan shqiptarë. Një prej tyre më tha se duhet të shkoj më të brenda. U nisa të shkoj, kur fëmijët dhe bashkëshortja filluan të qajnë, pasi nuk dinin çka po ndodh me mua. Më morën dhe më dërguan te vendi ku ishin brenda dhe të gjithë ata që ishin të pranishëm në kolonën e veturave dhe familja ime, kanë menduar se ata do të më rrahin shumë. Aty më bënë pyetje dhe kërcënime të ndryshme për një kohë, pas kësaj bisede më lëshuan dhe me familje u nisa për në Aeroportin e Beogradit", tha ai, duke shtuar se pak para se të arrijnë në Aeroportin e Beogradit fëmijët i kërkuan ushqim. "Kur u ndalëm te një restorant, brenda aty kishin qenë disa çetnikë me mjekra. Si i pamë ata nuk morëm asgjë, vetëm dolëm jashtë për shkak të frikës se çka mund të na ndodhë". Sfidat e radhës për familjen Gjuraraj ishte kontrolli për të hyrë në aeroplan dhe për të vazhduar drejt Amerikës. "Në orën 03:00 të mëngjesit arritëm në Aeroportin e Beogradit. Kemi pritë jashtë derisa u hap aeroporti dhe ishim të parët në rend për ta dorëzuar bagazhin. M'i kërkuan pasaportat, i shikuan dhe më thanë se vetëm tre veta mund të shkoni për Amerikë, ndërsa tre të tjerë nuk mundeni, sepse nuk keni bileta të rezervuara. Unë u thashë se nuk e lëshoj vendin pa m'i dhënë të gjashtë biletat, sepse i kam paguar të gjitha. Ma sollën një përkthyes dhe ai më tha se nuk mund të shkoni të gjithë

ja zë. 'Po të pyes edhe një herë', më tha, kurse unë i thashë: 'Largohu!' Nuk kam ditë gjë veç kur më kanë rrethuar tre persona, m'i kanë lidhur duart, kurse unë u thosha se nuk di të flas gjuhën serbe, se flas vetëm anglisht. Më pas më sollën një përkthyes dhe ai po më pyet se çka ka ndodhur. Unë i tregova se isha duke kërkuar tualet për fëmijët e këta m'i lidhën duart. Më tutje ua shpjegoj atyre se çka isha duke kërkuar dhe më lëshuan, edhe pse kanë qenë shumë të dhunshëm", tregon ai, duke shtuar se pastaj mbërriti në tokën e Kosovës. "Pashë disa vetura me flamur kuq e zi".



## Në sheshin qendror të qytetit Waterbury të ShBA-së Mhill Gjuraraj ngriti flamurin e Kosovës

Komuniteti shqiptaro-amerikan në Amerikë njihet gjithmonë si kontribuuesi kryesor për pavarësinë e Kosovës. Këtë e ka dëshmuar edhe me rastin e 11-vjetorit të pavarësisë së Republikës së Kosovës. Në sheshin qendror të qytetit Waterbury të shtetit Connecticut të Shteteve të Bashkuara të Amerikës u ngrit flamuri i Kosovës nga shqiptaro-amerikani Mhill Gjuraraj, i cili në këtë ditë u zgjodh "Kryetar i Ditës" - The Mayor of the Day" e, po ashtu, edhe nga shefja e misionit diplomatik të Kosovës në Nju Jork, Teuta Sahatqija. Në këtë ditë të rëndësishme të komunitetit shqiptaro-amerikan, Monroe Webster, sekretar i kryetarit të Bashkisë së qytetit të Waterburyt, Neil M. O'Leary, pati thënë se ndihet i nderuar që në këtë ditë të veçantë është pjesë e kësaj ngjarje shumë të rëndësishme për komunitetin shqiptaro-amerikan. "Ne do të jemi gjithmonë përkrah komunitetit

shqiptaro-amerikan dhe do të vazhdojmë të jemi bashkë për shtetndërtimin e Kosovës", pati thënë ai. Ndërkaq Mhill Gjuraraj, i cili u zgjodh "Kryetar i Ditës - The Mayor of the Day", një biznesmen, humanist aktiv dhe aktivist i çështjes kombëtare, uroi shtetin e Kosovës për ditën e pavarësisë, duke theksuar se është i gëzuar i gjithë komuniteti shqiptar në Amerikë. "Faleminderit Amerikë për çdo gjë që keni bërë për shtetin e Kosovës. Zoti e bekoftë Amerikën dhe Zoti e bekoftë Kosovën!", pati thënë me pak fjalë njeriu që u zgjodh ta ngrehë flamurin e Kosovës në sheshin qendror të qytetit Waterburyt. Megjithatë, në fund Gjuraraj ka një porosi për të gjithë shqiptarët që jetojnë jo vetëm në Amerikë, por në mbarë diasporën. "Ata që e ndiejnë vetën shqiptarë, sidomos ata që ia duan të mirën kombit shqiptar, të bëhen bashkë siç kanë qenë gjithmonë në shërbim të atdheut dhe të kombit".



pasi nuk janë të gjitha biletat. Pas shumë bisedave dhe përpjekjeve, ata më lëshuan, sepse unë u thosha se i kam paguar gjashtë biletat dhe i kisha ato. Hymë në aeroplan dhe nuk kam besuar se kam marrë rrugën për në Amerikë derisa u nis aeroplani. Dua të them se më asnjëherë nuk e kam marrë dhe

as që do ta marr një rrugë të tillë kah Beograd, sepse përvoja ka qenë shumë e hidhur, e vështirë dhe me shumë maltretim", thotë Gjuraraj, duke veçuar se tash e 20 vjet ai bashkë me familje vizitojnë Kosovën gati çdo vit: "E duam vendin tonë, Kosovën. E duam popullin shqiptar, sepse është vendi ynë".



## Amerikanët dhe talebanët shkëmbejnë akuza për situatën në Afganistan

ISLAMABAD, 19 MAJ - Talibanët dhe zyrtarët ushtarakë amerikanë kanë akuzuar njëri-tjetrin në medien sociale për veprime kundër vendosjes së paqes në Afganistanin e shkatërruar nga lufta.

Përplasjet në "Twitter" mes kundërshtarëve, vijnë ndërsa amerikanët dhe përfaqësuesit e grupit kryengritës janë të angazhuar prej një viti në dialog, në një përpjekje për t'i dhënë fund konfliktit. Por bisedimet nuk kanë rezultuar në ndalimin apo zbutjen e veprimeve luftarake të talebanëve në fushëbetë. Vetëm gjatë ditëve të fundit si pasojë e përplasjeve vdekjeprurëse mes

kryengritësve talebanë dhe forcave afgane të sigurisë të mbështetura nga Shtetet e Bashkuara, janë vrarë e plagosur me qindra persona, përfshirë edhe civilë.

Zëdhënësi i talibanëve Zabihullah Mujahid, shkruante në twitter se "Uashingtoni dhe jo grupi i tij, është kundër përpjekjeve për paqe". Ai përsëriti qëndrimin tradicional të talebanëve se ndërhyrja ushtarake amerikane në Afganistan është përgjegjëse për luftën 17-vjeçare.

Postimi i tij në "Twitter" ishte përgjigje ndaj një komenti që kishte bërë më parë zëdhënësi i Ushtrisë amerikane Kolonel Dave

Butler. Ai shkruante se "talebantët po dëmtonin afganët që duan paqe në vend".

Zëdhënësi i talibanëve i kërkonte Butler të fliste vetëm në emër të amerikanëve dhe "të mendojë rreth mënyrave se si amerikanët t'i japin fund pushtimit të Afganistanit, në vend që të flasin në emër të tij", siç shkruante ai.

Por Butler u përgjigj duke shkruar se grupi taleban "ka mundësinë të ulë intensitetin e dhunës, por nuk po e bën këtë". Talibanët shkruante ai "kanë zgjedhur të injorojnë vullnetin e popullit dhe të dëmtojnë vendin. Paqja është rruga e drejtë", shkruante ndër të tjera zëdhënësi i Ushtrisë amerikane.



## Fitore e papritur e koalicionit qeverisës në Australi

Gara e ngushtë ka rritur shanset që koalicioni të formojë një qeveri të pakicës pasi konservatorët janë një qeveri e pakicës qëkur larguan nga detyra e kryeministrit Malcolm Turnbull dhe vendosën në vend të tij Scott Morrisonin, pasojë e një lufte të brendshme për pushtet në gushtin e kaluar

KANBERA, 19 MAJ - Koalicioni konservator që qeveris Australinë korri një fitore të papritur në zgjedhjet e përgjithshme që u zhvilluan të shtunën, duke sfiduar sondazhet e opinionit që i jepnin përparësi në këtë garë partive opozitare të qendrës së majtë.

Kryeministri Scott Morrison e krahasoi fitoren e Partisë Liberale që ai drejton, për një mandat të tretë, me lindjen e vajzave të tij, Abbey 11 vjeç dhe Lily 9 vjeç. Pas përpjekjeve pa sukses për 14 vjet për shtatzëni, duke përdorur metodën in-vitro, vajzat erdhën në jetë me lindje natyrale. "Kam besuar gjithnjë në mrekulli", i tha

51 vjeçi Scott Morrison një turme njerëzish të ngazëllyer në Sidnei ndërsa shpalli fitoren. "Jam këtu me tri mrekullitë më të mëdha të jetës sime dhe sonte kemi arritur një tjetër mrekulli", tha ai.

Udhëheqësi i opozitës, Bill Shorten, e kishte pranuar më parë humbjen, ndërsa koalicioni qeverisës siguroi shumicën në Dhomën e Përfaqësuesve të përbërë nga 151 vende. Numërimi i votave ka vazhduar edhe të dielën. "Jam i zhgënjyer për njerëzit që varen nga partia jonë, por unë jam i kënaqur që bëmë atë çfarë ishte e drejtë, jo atë që ishte më e lehtë", u tha ia mbështetësve të tij.



Shorten tha se nuk do ta udhëhiqte më Partinë e Punës pas gjashtë vitesh në krye të saj. Gara e ngushtë ka rritur shanset që koalicioni të formojë një qeveri të pakicës. Konservatorët janë një qeveri e pakicës që kur larguan nga detyra e kryeministrit

Malcolm Turnbull dhe vendosën në vend të tij Scott Morrison, pasojë e një lufte të brendshme për pushtet në gushtin e kaluar. Sondazhet e opinionit para zgjedhjeve të së shtunës sugjerorin se koalicioni do të humbiste dhe se Morrison do të kishte një nga

mandatet më të shkurtra si kryeministër në historinë 118-vjeçare të Federatës australiane. Morrison e përqendroi fushatën e tij për të treguar se ndërsa Partia e Punës ishte më popullore sesa qeveria, kryeministri i vendit (vetë ai) ishte më popullor se Shorten.

## Austria shkon në zgjedhje në shtator pas skandalit të korrupsionit



VJENË, 19 MAJ - Presidenti i Austrisë, Alexander van der Bellen, ka thirrur zgjedhje të jashtëzakonshme në muajin shtator, pas skandalit politik ku përfshihet një video incizim sekret që shfaq zëvendëskancelarin e shtetit, Heinz-Christian Strache duke i ofruar kontrata qeveritare një përfitueses ruse, në këmbim të donacioneve poli-

tike. Pas takimit me kancelarin austriak Sebastian Kurz, presidenti tha se zgjedhjet duhet të mbahen në fillim të muajit shtator. Kurz të shtunën kërkoi zgjedhje të parakohshme derisa mijëra protestues me pankarta ku shkruante "zgjedhjet e parakohshme tani", u mblodhën jashtë zyrës së Kurz në

Vjenë. Ky vendim erdhi disa orë pas dorëheqjes së Straches nga pozita, i cili e pranoi fajin për veprimet e tij duke thënë se sjellja e tij ishte "e papërgjegjshme" dhe se po dilte nga qeveria për të shmangur dëmet e mëtejshme të qeverisë. Dorëheqja e tij vjen pas publikimit të një incizimi nga gazeta

Der Spiegel, ku shihet duke i ofruar kontrata qeveritare një gruaje që paraqitet sikur investitore e pasur nga Rusia, dhe prezantohet sikur mbesa e një biznesmeni të njohur rus. Kjo ngjarje kishte ndodhur më 2017 në Ibiza, disa muaj para zgjedhjeve parlamentare në Austri, ku Strache u emërua zëvendëskancelar.

## May planifikon ofertë të guximshme për ta arritur mbështetjen për Brexitin

LONDËR, 19 MAJ - Kryeministrja britanike Theresa May tha se do të prezantojë një ofertë të re më të guximshme të ligjëvënës, me "një pako të masave të përmirësuar" në tentativën e fundit për daljen nga Bashkimi Evropian me marrëveshje, para se të përfundojë

mandatin. Pas dështimit tri herë radhazi për të marrë aprovimin e Parlamentit për marrëveshjen e Brexit-it, Qeveria britanike tani do të vendosë projektligjin, legjislacion që do të vendosë për këtë çështje, para votimit në Parlament në qershor. "Sido që të

jetë rezultati i votimit, unë nuk do të kërkoj nga ligjëvënësit të mendojnë sërish. Por, do të kërkoj që të shikojnë marrëveshjen e re të përmirësuar me "sy të ri" dhe ta mbështesin", tha May. Sipas raportimeve të medieve britanike, May do të konsultohet

me kolegët e kabinetit për ndryshimet e propozuara për marrëveshjen e largimit nga blloku. Rreth 3 vjet pas votimit pro të Britanisë prej 52 për qind në referendumin e largimit nga BE-ja, ende mbetet e paqartë se si, kur apo a do të largohet fare nga blloku



që iu bashkua më 1973. Afati përfundimtar për largim është 31 tetori.



# Papa me origjinë shqiptare Klementi XI dhe ikona e famshme e Shën Mërisë në qytetin Çenstohova të Polonisë

**Leonard Zissi** – Në pjesën perëndimore të qytetit Çenstohova (Cz?stochowa) që ndodhet në jug të Polonisë, është një kodër 293 metra e lartë mbi nivelin e detit, që quhet Jasna Gura (Jasna Góra). Në këtë kodër, që polakët e konsiderojnë si Sankturium (vend i shenjtë), mbi themelet e një kishë të vjetër që quhet “Virgjëresha e Bamirësisë Shumë e Shenjta Shën Mëri”, nga Urdhëri katolik i Paulinëve që erdhën në Poloni nga Hungaria, në vitin 1382 u ndërtua një Manastir, bashkë me kompleksin e tij. Në këtë Manastir ndodhen shumë vepra arti të bukura kishtare, por më e rëndësishme është Ikona e Shën Mërisë që mban Jezu Krishtin në krahun e majtë. Për shkak të ngjyrës bronz të errët të fytyrës së Shën Mërisë dhe Jezu Krishtit, si rrjedhojë e përdorimit të vernikëve gjatë restaurimeve të shpeshta që i janë bërë Ikonës ndër vite, ajo ndryshe quhet “Madonna e Zezë”.

Ikona ka përmasat 122x82 cm. dhe është shkruar mbi një dërrasë prej trangu bliri. Ajo paraqet Shën Mërinë të veshur me një fustan ngjyrë blu të errët, të mbuluar me një pelerinë, veshur me një astar të kuq, duke mbajtur në krahun e majtë Jezu Krishtin fëmijë. Pamjen e fytyrës ajo e drejton drejt qendrës, ndërsa gjishtërinjtë e dorës së djathtë i drejton tek Jezu Krishti, si për të treguar se Ai është burim shpëtimi. Nga ana e tij Jezu Krishti dorën e djathtë e drejton drejt qiellit si shënjë e bekimit nga Perëndia, ndërsa në dorën e majtë mban librin e Biblës.

Në historinë e krishtërit thuhet se, ikonat e para me fytyrën e Shën Mërisë dhe Jezu Krishtit, janë shkruar (për ikonat thuhet se shkruhen dhe jo pikturohen) nga Shën Lluca Evangjelisti, që ka jetuar në shekullin I të erës sonë. Ai shkroi shtatëdhjetë ikona, dy prej të cilave thuhet se njera ndodhet në Bolonjë të Italisë ndërsa ikona e dytë ndodhet në Jeruzalem. Ushtarët e Kruqëzatave, në shekullin I, atë e gjetën të fshehur në një guvë dhe pastaj e vendosën në një kishëzë të Jeruzalemit. Në vitin 326 atë e gjeti Shën Elena, nëna e Perandorit Konstadini i Madh (274-337) një prej perandorëve më të shquar të Perandorisë Romake, themeluesi i Konstandinopojës në vitin 330, të cilit ia dhuroi atë atij .Konstadini i Madh dëshironte që këtë Ikonë ta vendoste në ndonjë kishë të sapondërtuar në Konstandinopojë, por për shkak të luftrave që zhvilloheshin në atë kohë, kjo nuk u bë e mundur dhe Ikona u vendos në muret e qytetit, prej së cilës thuhet se armiqët tmerroheshin dhe nuk mundën ta pushtohet atë. Kjo mund të konsiderohet “mrekullia” e parë e kësaj Ikone.

Më pas, Konstadini i Madh dëshironte që Ikonën t’ia dhuronte një princi rus, por kjo



nuk u realizua prej tij. Kronikat ruse thonë se Ikona, nga Konsandinopoja, fillimisht në vitin 1270, ka mbërritur në qytetin polak Lvov (sot ndodhet në territorin e Ukrainës) dhe pastaj në kështjellën e princit polak Vladislav Opolczyk, që ndodhej në qytetin Bellza, që edhe ai bënte pjesë në Mbretërinë Polake. Gjatë transportit të saj për në kryeqytetin e mbretërve polakë të Krakovit, kuajt e karrocës ndaluan në qytetin e Çenstohovës dhe nuk donin të lëviznin nga vendi. Legjenda thotë se kjo ishte shenjë e Shën Mërisë që ikona e saj donte të kishte shtëpinë e qëndrimit të përhershëm në Çenstohovë. Për këtë arsye, princi Opolczyk, më 11.VIII.1384, Ikonën ia dhuroi Urdhërit të Paulinëve që kishin ndërtuar kishën e tyre në kodrën në Jasna Gura, ku ndodhet edhe sot e kësaj dite.

Gjatë periudhave që pasuan, Ikona ka pasur historinë e saj. Ajo shpesh u grabit dhe u dëmtua, sa që në faqen e fytyrës së Shën Mërisë edhe sot e kësaj dite kanë mbetur shenjat e dy viaskave të shkaktuara nga goditjet me shpatë që i janë bërë asaj prej keqbërësve, kështu që ajo u nënshtruar restaurimeve të vazhdueshme. Restaurimi i parë është bërë pas dëmtimit të saj prej sektit të krishterëve të Husëve në vitin 1430, ku u tentua të zëvendësohej ngjyra e zakonshme e fytyrës së Shën Mërisë dhe Jezu Krishtit që përdorej në ikonat ortodokse bizantine, me ngjyrën e errët të vernikut. Kështu që ngjyrat e të dy fytyrave të tyre në Ikonë u zbehën në ngjyrën bronz të errët. Restaurimi i fundit është bërë në vitin 1948 ku u përdorën edhe rrezet rentgen. Analizat treguan se ngjyra e fytyrave të tyre fillimisht ishte e çelur dhe jo e ngjyrës bronz të errët të tanishme.

Rreth kësaj Ikone kanë ndodhur shumë ngjarje, por më e rëndësishmja, që i ka dhënë famë të madhe jo vetëm brenda Polonisë, por edhe jashtë saj, është ajo që ka ndodhur në vitin 1655, kur Suedia kish përgatitur një plan për të pushtuar Poloninë. Më 21 korrik të atij viti, ushtritë suedeze kaluan kufirin polak, duke shtënë shumë shpejt në dorë Varshavën, Poznanin dhe Krakovin. Në këto rrethana fisnikëria polake nuk



donte të luftonte dhe kështu, pothuajse i gjithë vendi, ra në duart e suedezeve. Më 18 nëntor 1655, ushtria suedeze që numuronte tre mijë ushtarë, u ndodh para mureve të Jasna Guras dhe kërkoi që fortesa të dorëzohej. Por administratori i fortesës vendosi të mbrojtë vendin e Shenjtë dhe të mos e dorëzonte atë, duke patur në dispozicion vetëm 170 ushtarë, 20 oficerë dhe 70 murgjër. Në krahasim me ushtrinë suedeze, forca mbrojtëse e fortesës së Jasna Gurës ishte rreth pesëmbëdhjetë herë më e vogël. Sulmin ndaj manastirit ata



e konsideronin si fyerje të ndjenjave të tyre fetare, sepse kështu përdhunosej vendi i Shenjtë që Shën Mëria kish zgjedhur për të qëndruar. Prandaj, çdo ditë ata faleshin para Ikonës dhe i luteshin Shën Mërisë për t’i mbrojtur nga suedezët. Dhe kështu ndodhi. Luftimet zgjatën dyzet ditë dhe, për mrekulli, përfunduan me fitoren e kalorësve të Manastirit. Kjo fitore pati një rëndësi të jashtëzakonshme, jo vetëm fetare, por edhe politike, që konsiderohej se ishte arritur nëpërmjet ndërhyrjes dhe përkujdesit të Shën Mërisë për të mbrojtur vendin e vet të shenjtë. Që nga ky çast i gjithë vendi u ngrit në luftë dhe fitorja anoi nga ana e polakëve, të cilën edhe sot e kësaj dite e konsiderojnë si një “Mrekulli” të dhuruar nga Shën Mëria. Për këtë arsye mbreti i Polonisë në atë kohë, Jan Kazhimiezhi I, në qershor të vitit 1656 pushtetin e vet mbretëror e dorëzoi tek Shën Mëria, duke e konsideruar Atë si Patronen dhe Mbretëreshën e Polonisë, vlerësim fetar që ka mbetur deri

në ditët tona.

Duke parë rëndësinë e kësaj Ikone dhe pas vendosjes së paqes në Poloni me mbarimin e luftrave me Suedinë, në vitin 1711 filloi një fushatë për kurorëzimin me kurorën Papnore të Ikonës. Për këtë u shfrytëzua vizita e Nuncit Apostolik të Vatikanit të asaj kohe dhe, me miratimin e tij, ata iu drejtuan zyrtarisht Vatikanit për këtë çështje. Në vitin 1716 Papa i Vatikanit nënshkroi Aktin Kanonik të kurorëzimit të Shën Mërisë dhe Jezu Krishtit me kurorën Papnore. Mbi bazën e këtij Akti, mbi kokën e Shën Mërisë dhe Jezu Krishtit u vu kurora Papnore, ku ceremonia e këtij kurorëzimi u zhvillua më 8 shtator 1717, me pjesëmarrjen e rreth 200 mijë besimtarëve polakë. Aktin e kurorëzimit të kësaj Ikone e nënshkroi Papa me origjinë shqiptare Klementi XI (1649-1721), duke u bërë kështu një pikë e rëndësishme takimi në historinë e marrëdhënieve midis dy popujve tanë, shqiptar dhe polak.

Një Mrekulli tjetër që polakët ia atribuojnë kësaj Ikone, është



edhe fitoria e Ushtrisë Polake, nën komandën e Mareshallit Jozef Pilsudski ndaj ushtrisë bolshevike ruse në vitin 1920. Atë vit, kjo ushtri e krijuar mbas Revolucionit të Tetorit të vitit 1917, synonte të eksportonte revolucionin proletar në Gjermani, ku vepronte një lëvizje e fuqishme komuniste. Me këtë synim, ajo depërtoi deri në dyert e Varshavës, buzë lumit Vistula. Ajo ishte në numur shumë më të madh nga ushtria polake, e cila sapo ishte formuar mbas rifitimit të pavarësisë së Polonisë më 1 nëntor të vitit 1918. Ndodhur në këtë situatë të pafavorshme ushtarake, polakët i faleshin vazhdimisht Ikonës së Shën Mërisë në Manastirin e Çenstohovës dhe i luteshin asaj që ushtria polake të përzinte ushtritë bolshevike nga Polonia. Edhe në këtë rast ndodhi mrekullia. Ushtria polake zbrapsi repartet bolshevike, çliroi Poloninë nga invazionin bolshevik dhe avancoi deri në dyert e Kievit. Me këtë fitore, ushtria polake shmangu avancimin e ushtrisë bolshevike drejt Europës Perëndimore, fatet

e së cilës nuk dihet sesi do të ishin po të ndodhte okupimi i saj nga kjo ushtri. Edhe këtë mrekulli që ndodhi, polakët ia atribuojnë edhe faljeve para Ikonës së Shën Mërisë në manastirin e Jasna Gurës të Çenstohovës dhe e quajnë Mrekullia mbi lumin e Vistullës.

Ndonëse kjo Ikonë me origjinë ortodokse bizantine është transformuar në Ikonë katolike, nderohet dhe vlerësohet shumë edhe nga të krishterët ortodoksë, veçanërisht nga ata të Ukrainës, Biellorusisë dhe Rusisë. Në atë kohë, asaj i ishin bërë kopje, të cilat qarkullonin në vende të ndryshme të Europës. Siç shkruan prifti polak Marçin Çeëminjski në veprën e tij të rëndësishme “SHQIPËRIA – përshkrime historike, etnografike, kulturore dhe fetare”, botuar në vitin 1893 në Krakov, përkthyer në shqip dhe botuar në Tiranë vitin 2014, një kopje e kësaj Ikone është sjellë edhe në Shqipëri në shekullin XIX nga një prift polak nga Galicia, e cila në atë periudhë ishte pushtuar nga Austria. Ajo ka qenë vendosur në altarin e kishës së Kallmetit prej peshkopit polak, Atë Françishek Mallçinjski, i cili në atë kohë shërbente në Lesh.

Ikona dhe Manastiri në Jasna Gura sot janë vende të shenjta jo vetëm për polakët, por edhe nga pelegrinët në shumtë dhe vizitorët që vijnë nga e gjithë bota. Ata bëjnë lutje të zakonshme, por edhe lutje për t’u shëruar nga sëmundje të ndryshme dhe për të patur fat në jetë. Me këtë rast ata japin edhe dhuratat të ndryshme si gurrë të çmuar, prodhime prej ari dhe argjendi, të cilat i vendosin në vende të caktuara të Manastirit. Numuri i vizitorëve të përvitshëm arrin në mbi 4 deri 6 milionë vetë, prej të cilëve rreth 300 mijë pelegrinët polakë vijnë në këmbë çdo vit nga e gjithë Polonia, një traditë e hershme kjo që nga shekulli XVIII. Sot ky pelegrinazh është nga më të mëdhenjtë në të gjithë botën. Shën Mëria e Çenstohovës festohet më 26 gusht të çdo viti.

Për lidhjen e ngushtë të kësaj Ikone me Papën me origjinë shqiptare, Klementin XI dhe për numurin e madh të pelegrinëve dhe vizitorëve që e vizitojnë atë nga e gjithë bota, do të ishte mirë që atyre t’u bëhej i njohur fakti se pikërisht ky Papë ka miratuar kurorëzimin e saj me kurorën Papnore të Shën Mërisë dhe Jezu Krishtit. Kjo do bënte shumë përshtypje pozitive tek të gjithë vizitorët, veçanërisht tek populli polak që është shumë besimtar katolik. Mendoj se Kisha Katolike në Shqipëri do të ishte mirë të kontaktonte me organet përkatëse të Kishës Katolike Polake dhe të mundësonte ekspozimin e portetit në pikturë të Papa Klementit XI, si dhuratë e saj për këtë Manastir.

/Gazeta Shqiptare



E jashtëzakonshme

## Studentët kinezë gjejnë vezë të dinozaurëve

Katër studentë kinezë gjetën një gurë të çuditshëm i cili më pas doli të jetë vezë e dinozaurëve. Grupi i studentëve gjeti vezën të mbuluar me baltë, gjatë një shëtitjeje në një fshatë. Stafii i quajtur ekspertë nga Akademia Kineze e Shkencave vështrroi zbulimin misterioz nga afër dhe konfirmoi se ishte vezë e dinozaurëve e milionave vjetëve më parë. Kjo vezë tani po mbahet në një muze në zonën e qytetit Pingxiang.



iona vjetëve më parë. Kjo vezë tani po mbahet në një muze në zonën e qytetit Pingxiang.

## BARSOLETA E DITËS



Burri i lë një letër gruas mbi tavolinë: - Shpirt, jam t'u dal me shokë. Kthehem pas një orë. Por, nëse nuk vij, lexoje edhe një herë.



### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit ne ora 14:00

#### “DUMBO” 3D

Fantazi/Familjar; 1 ore 52 min

**Rolet:** Colin Farrell, Michael Keaton, Danny DeVito, Eva Green, Alan Arkin, etj.  
**Regjia:** Tim Burton



#### Ne ora 16:00 dhe 19:00 “AVENGERS; Endgame”

Aksion/Aventurë/Fantazi; 3 ore 02 min

**Rolet:** Robert Downey Jr., Chris Evans, Mark Ruffalo, Chris Hemsworth, Scarlet Johansson, Don Cheadle, Bradley Cooper, Gwyneth Paltrow, Jeremy Renner, Josh Brolin, etj.  
**Regjia:** Anthony Russo, Joe Russo



Në ora 20:00

#### “EXTREMELY WICKED, SHOCKINGLY EVIL, AND VILE”

Krim/Mister; 1 ore 48 min

**Rolet:** Zac Efron, Lily Collins, Kaya Scodelario, Jeffrey Donovan, Angela Sarafyan, Dylan Baker, John Malkovich, etj.  
**Regjia:** Joe Berlinger



FOTO E DITES



Një person bie nga kali gjatë një gare me dema në Las Ventas të Spanjës. /AFP/

E rrallë

## Makina që shndërron shishet e birrës në rërë

Ekzistojnë disa makina që i shndërrojnë shishet e birrës në rërë brenda pak sekondash. "DB Export Beers" është kompania që ka krijuar këtë makinë rëre. Në këtë makinë vendosen shishet e thata të birrës të cilat pastaj thërrmohen dhe shndërrohen në zëvendësim të rërës.



16.05.2019

#### “THE HUSTLE”

Komedi

**Rolet:** Anne Hathaway, Rebel Wilson, Alex Sharp, Dean Norris, etj.

**Regjia:** Chris Addison

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe **boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

<p><b>DASHI</b> Nëse nuk doni t'ju kritikojnë sot, duhet patjetër të sqaroni një situatë të ndërlikuar që ka prekur jo pak njerëz. Ju keni gjeneruar gjithçka.</p>	<p><b>DEMI</b> Sot do t'ju anulohen të gjitha planet që keni bërë për ditën si pasojë e një çështje që do të dalë papritur dhe kërkon zgjidhje emergjente.</p>	<p><b>BINJAKËT</b> Mbase keni shpresuar më tepër sesa që duhet në disa ngjarje që nuk kanë ndodhur ende. Bëni një bilanc të ditës suaj dhe ndryshoni qëndrim.</p>	<p><b>GAFORRJA</b> Mos lejoni që sot të neglizhohet një projekt i caktuar që ka afatet e veta. Nëse ndodh kjo gjë, të gjitha pasojat do të bien mbi ju.</p>	<p><b>LUANI</b> Ka disa mundësi sot për të dalë nga një situatë e bezdisshme që po ju shqetëson. E rëndësishme është të zgjidhni atë që bie më pak në sy.</p>	<p><b>VI R G J Ë R E S H A</b> Nuk ka pse t'ju kapë paniku për gjëra që nuk janë verifikuar ende. I keni të gjitha mënyrat për ta sqaruar pozicionin tuaj.</p>
<p><b>PESHORJA</b> Nëse nuk doni të përshkoni shumë rrugë sot për të arritur në përfundimet e kërkuara, duhet t'i besoni intuitës suaj.</p>	<p><b>AKREPI</b> Sot doni të jeni sa më pranë personave që punojnë me ju. Mbase duhet të kuptoni dhe nevojat e tyre dhe të mos tregoheni egoist.</p>	<p><b>SHIGJETARI</b> Po përçoni stres te personat afër jush sepse dhe ju vetë në këto çaste jeni shumë të ngarkuar. Ruani qetësinë.</p>	<p><b>BRICJAPI</b> Nëse nuk keni arritur të zgjidhni një problem familjar, sot duhet t'i kushtoni të gjithë kohën e nevojshme. Edhe familja ka kërkesat e veta.</p>	<p><b>UJORI</b> Meqë tani jeni në lojë duhet të filloni të ecni sipas rregullave të lojës. Prisni kohën tuaj dhe veproni me maturi për të qenë sa më të sigurt.</p>	<p><b>PESHQIT</b> Keni marrë disa vendime që ju kanë vënë në mendime sot. Mbase nuk ishte mënyra e duhur ajo që zgjodhët për t'i bërë publike.</p>



## Fero ka pasur një 'problem' para se të njihej me Arbenitën



**H**istoria e dashurisë së reperit Fero dhe modelueses Arbenita Ismajli jo vetëm se është me e komentuar në rrjetet sociale, por ndër më të bukurat. Para se ta njihje Arbenitën, Fero ka deklaruar në "E diell" se kishte pasur një "problem" me të, por që u sheshua me kalimin e kohës. "Unë gjithmonë e kam dashur

veten shumë, por Arbenita më ka bërë konkurrencë të singertë, kështu që tani e dua atë më shumë", rrëfeu reperi. Disa ditë më parë çifti ka provokuar përdoruesit e rrjeteve sociale me një postim që ishin ndarë, por që në fund rezultoi se ishte një shaka e cila nxori në pah, sipas Arbenitës, të gjithë urrejtjen e njerëzve.

## Holanda triumfon në Evrovision



**H**olanda ka fituar edicionin e 64-t të Festivalit të Këngës në Evrovision. Duncan Laurence, që solli këngën "arcade", shihej si një nga favoritët për të fituar në Tel Aviv. Në vend të dytë u

rendit Italia, e ndjekur nga Rusia në të tretin. Në këtë finale Shqipëria u përfaqësua nga Jonida Maliqi me këngën "Ktheju tokës", e cila u rendit në vendin e 18 me 90 pikë gjithsej.




## Kanye i rikthehet punës pas lindjes së fëmijës së katërt

**K**anye West i është kthyer punës pas lindjes së fëmijës së katërt. Reperi 41-vjeçar është parë të premten duke shkuar në zyrën e vet në

Calabajas të Kalifornisë. Një ditë më parë Kanye dhe bashkëshortja e tij Kim Kardashian zbuluan emrin e djalit të porsalindur që është Psalm.

## Jonathan dhe Tara bëhen me binjakë



**J**onathan Tucker dhe bashkëshortja e tij Tara kanë mirëpritur në jetë binjakët e tyre. Çifti u bë me një djalë dhe vajzë në Los Angeles, raporton "ET". Ata ende nuk kanë vendosur për emrat, por burime

pranë tyre kanë thënë se çifti është jashtëzakonisht i emocionuar. Çifti konfirmoi shtatzëninë në shkurt. Jonathan dhe Tara janë martuar në vitin 2012 pasi u fejuan në një ceremoni romantike në Nju Jork.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE  
**"BUJQËSIA"**  
TEL: 045 82 82 82

# Feronikeli shpallet kampion i Kosovës

Feronikeli e ka fituar titullin e kampionit për herë të tretë në histori të klubit, duke arritur të grumbullojë 80 pikë. Në barazh do të luajnë Trepça '89 dhe Gjilani, kurse nga Superliga janë larguar Liria dhe KEK-u. Duhet cekur se anëtare të reja të elitës janë Vushtrria dhe Dukagjini, kurse Besa dhe Vëllaznimi kërkojnë rikthimin në elitë nëpërmjet barazhit

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 19 MAJ** - KF Feronikeli e ka shkruar historinë e re në futbollin e Kosovës pasi është shpallur kampion për edicionin 2018/2019. Në ndeshjen e fundit në stadiumin "Rexhep Rexhepi", Feronikelit i mjaftonte edhe barazimi për ta siguruar titullin, por djelmohat e drejtuar nga trajneri Zekrija Ramadani e mposhtën Prishtinën me rezultat 1-0. "Është një kënaqësi e madhe duke e marrë parasysh se deri në fund s'ishim të gëzuar për titull. E falënderojmë Prishtinën për luftën që ka bërë, lojën fer dhe korrekte. Dëshmoi që është skuadër e madhe. Ua uroj fitoren tifozëve. Ishim më këmbëngulës për ta arritur golin duke ditur rrezikun", ka thënë sulmuesi i Feronikelit, Kastriot Rexha.

Vendësit e nisën më mirë ndeshjen duke e pasur kontrollin në minutat e parë, por më pas Prishtina arriti ta kalojë presionin dhe të dalë në lojën e saj. Në minutën e 20 Yll Hoxha tentoi ta gjejë sulmuesin Rexha, por intervenoi mbrojtja mysafire, duke e larguar topin nga zona. Dy minuta më vonë Bekaj bëri një lëshim të cilin Mendurim Hoti nuk e shfrytëzoi duke i dhënë mundësinë Bekajit që ta rikuperojë gabimin. Në minutën e 37 Feronikeli e regjistroi rastin e parë, por sulmuesi Kastriot Rexha gjuajti plogësht pranë portës së Prishtinës.

Në pjesën e parë, pas një kundërsulmi të Hotit dhe Fazliut, Da Silva



shpërdoroi një tjetër rast shënimi. Në anën tjetër, Prishtina nuk pati ndonjë rast konkret në pjesën e parë. Në fillim të pjesës së dytë vendësit u munduan ta shënojnë golin e parë, por Bekaj ishte në vend. Në anën tjetër, trajneri Mirel Josa e inkuadroi në lojë Mërgim Pevqelin në vend të Marijo Morinës për ta ngjallur sulmin, por edhe Pevqeli nuk tregoi shumë. Trajneri kryeqytetas me kalimin e minutave në lojë inkuadroi edhe Mustafën dhe Jasharovskin. Në minutën e 73-të, Kastriot Rexha u falua dhe nga gjuajtja e lirë harkoi Yll Hoxha, por topi përfundoi në rrjetë. Në minutat në vazhdim Prishtina u mundua të rikthehet në lojë por, pa sukses. Vlen të ceket

rasti i Jashroveskit në minutat e fundit, por që ndeshja përfundoi 1-0. Ndërsa heroi i "Niklit" në këtë ndeshje, Yll Hoxha, golin e shënuar ia ka dedikuar familjes dhe djalit të tij. "Kam shumë respekt të madh për Prishtinën. Jam rritur aty. Respekt. Më erdh keq për ta, por më erdhi mirë për ekipin tim. Dua t'ia dedikoj golin familjes sime dhe djalit tim", ka deklaruar Hoxha.

## Gjilani dhe Trepça '89 luajnë në barazh

Trepça '89 e shkatërroi KEK-un duke e mposhtur me rezultat 4-0, por kjo nuk ishte e mjaftueshme për ta siguruar mbijetesën drejt-

përdrejt. '89-shtit i duhet të luajë në barazh për të arritur një gjë të tillë. Hasan Hyseni realizoi dy gola për mitrovicasit, kurse nga një e shtuan Lassine Traore dhe Franck Herman. Skuadra tjetër që do të luajë në barazh është Gjilani, i cili fillimisht kishte epërsinë ndaj Ferizajt 0-1, por në fund e humbi ndeshjen me rezultat 2-1. Po t'i merrte pikët maksimale në këtë ndeshje skuadra nga Anamorava, gjithçka do të ishte e pamjaftueshme, për faktin se skuadrat e tjera që mund t'i rrezikonte arritjen fitore në ndeshjet e fundit. Duhet cekur se skuadra e Ferizajt ka qenë ndër më të mirat në pranverë dhe si rezultat i kësaj e mbylli kampionatin në pozitën e pestë me 46 pikë.

### IPKO SUPERLIGA

Feronikeli - Prishtina	1-0
Flamurtari - Llapi	3-2
Ballkani - Drita	2-0
Liria - Drenica	1-3
Trepça '89 - KEK-u	4-0
Ferizaj - Gjilani	2-1

### TABELA

		PIKË
1. Feronikeli	33	80
2. Prishtina	33	75
3. Llapi	33	69
4. Drita	33	48
5. Ferizaj	33	46
6. Flamurtari	33	45
7. Drenica	33	43
8. Ballkani	33	43
9. Trepça '89	33	42
10. Gjilani	33	38
11. Liria	33	28
12. KEK-u	33	1

### LIGA E PARË

Ramiz Sadiku - 2 Korriku	2-1	
Fushë Kosova - Vitia		1-0
Dukagjini - Drenasi		2-0
Arbëria - Istogu		3-1
Vllaznia - Trepça		2-0
Vëllaznimi - Bashkimi (K)		1-2
Kika - Besa		1-1
Onix - Vushtrria		0-1

### TABELA

		PIKË
1. Vushtrria	30	72
2. Dukagjini	30	59
3. Besa	30	59
4. Vëllaznimi	30	54
5. Vitia	30	47
6. Trepça	30	38
7. Istogu	30	38
8. Onix	30	37
9. Arbëria	30	37
10. Drenasi	30	35
11. 2 Korriku	30	35
12. Vllaznia	30	34
13. Ramiz Sadiku	30	33
14. Bashkimi (K)	30	32
15. Fushë Kosova	30	31
16. Kika	30	29

# Dështon Kuvendi i Federatës së Atletikës



**PRISHTINË, 19 MAJ** - Nuk është mbajtur të dielën Kuvendi i Federatës së Atletikës së Kosovës pasi është bojkotuar nga delegatët e vet të cilët e akuzojnë kryetarin e federatës, Halil Sylejmanin, për udhëheqje autokrate. Nga 26 delegatë me të drejtë vote sa i ka ky kuvend, vetëm 10 kanë qenë të pran-

ishëm në takim, prandaj edhe ka dështuar mbajtja e tij. "Njoftojmë se ka dështuar Kuvendi i Punës i Federatës Atletike të Kosovës që ishte i paraparë të mbahej më 18.05.2019 në hotel 'Sirius' prej orës 16:00. Arsyetimet e delegatëve që e bojkotuan kuvendin e punës janë: 1. Udhëheqja autokrate e Federatës nga

kryetari Halil Sylejmani; 2. Mospërfillja e mendimeve dhe vendimeve të kryesisë se Federatës dhe selektorëve; 3. Zbehja e imazhit të Federatës tek institucionet sportive vendore dhe ndërkombëtare; 4. Bashkëpunimi i dobët me media", thuhet në njoftimin e FAK-ut.

## Kosova rrëmben katër medalje në Greqi

**PRISHTINË, 17 MAJ** - Bodibilderi Besard Maxharraj në kategorinë deri në 100 kg është shpallur kampion dhe kampion absolut në të gjitha kategoritë e bodibildingut. Vendi e parë në kategorinë -85 kg e ka zënë Kushtrim

Bajraktaraj, kurse vendin e dytë në Classic bodibilding në kategorinë -180 cm e zuri Aldon Sadiku. Në vendin e tretë përfundoi Flamur Gerbavci në Classic bodibilding në kategorinë -175 cm, kurse Blerta Ibrahim

Wellnes përfundoi në vendin e gjashtë. Në Classic bodibilding, kategoria +180 cm, i shtati doli Florent Kadrolli. Delegacionit të Kosovës në Kampionatin e Ballkanit në Badibilding dhe Fitnes që është

mbajtur në Corfu të Greqisë i ka prirë kryetari i Federatës së Badibildingut dhe Fitnesit, Esat Lata dhe sekretari gjeneral i FBBFK-së, Sabri Dragusha, si dhe nënkryetari i Komitetit Olimpik të Kosovës, Gazmend Maxhuni.





## Delegacioni i UEFA-s të mërkurën viziton Kosovën

PRISHTINË, 17 MAJ - Një delegacioni i UEFA-s të mërkurën do të jetë për një vizitë në Kosovë. Kjo vizitë vjen pas takimit që drejtuesit e FFK-së patën me përfaqësuesit e

UEFA-s në Budapest, e ku u diskutua e ardhmja e ligave kombëtare dhe ku u aprovua kërkesa e FFK-së për pjesëmarrjen e një klubi tjetër në garat evropiane që nga viti i

ardhshëm. "Gjatë qëndrimit në Kosovë delegacioni i UEFA-s do ta shikojë gjithë rrjedhën e garave si dhe projektet që po i realizon FFK-ja dhe ato që parashikon

t'i realizojë në periudhën e ardhshme. Po ashtu, delegacioni i UEFA-s, do të mbajë edhe një konferencë për media", thuhet në njoftimin e FFK-së.



## Kampionët nuk ndryshojnë në pesë ligat më të forta



MÜNCHEN, 17 MAJ - Sezoni 2018/2019 do të hyjë në historinë e futbollit evropian pasi për herë të parë në të pesë kampionatet më të rëndësishme të kontinentit triumfuan duke e fituar titullin sikurse në sezonin paraardhës. Në Spanjë, Gjermani, Francë, Itali dhe Angli u rikonfirmuan si kampionë Barcelona, Bayerni, Paris Saint Germaini, Juventusit dhe Manchester City. Barcelona e fitoi titullin në Spanjë katër javë përpara fundit. Skuadra e Valverdes ishte dominuese e La Ligas dhe e fitoi me shumë

autoritet këtë titull që ishte i katërti në pesë vjetët e fundit dhe i 26 në historinë e kësaj skuadre. Në Itali, Juventusit e siguroi titullin në 20 prill në sfidën me Fiorentinën. Për "Zonjën e Vjetër" ky ishte titulli i tetë radhazi në Serinë A dhe i 35-ti në historinë e tij Manchester City u desh ta priste javën e fundit për t'u shpallur kampion për të dytin vit radhazi me Guardiolen në stol dhe të gjashtë herët në historinë e tij. Meritë për këtë ka edhe Liverpooli që dueli fort me skuadrën e "Citizens", por pa mundur dot ta mposhtë në

fund. Paris Saint Germain e fitoi titullin e dytë radhazi kampion më 21 prill pasi kishte siguruar një avantazh të thellë ndaj skuadrës së Lille në vendin e dytë. Për skuadrën parisienne ai i këtij sezoni ishte titulli i tetë kampion në Ligën 1 në historinë e tij. Këtyre skuadrave i bashkohet Bayerni i cili, ashtu sikurse edhe Manchester City, i mbylli llogaritë e titullit në Bundesligë në javën e fundit pas fitores 5-1 ndaj Eintrachtit të Frankfurtit. Për "bavarezët" ky i sezonit 2018/2019 ishte titulli i 7 radhazi dhe i 28 në historinë e tij.

## Golden State, 'leksion' Portlandit, pranë titullit kampion në Perëndim

PORTLAND, 17 MAJ - Skuadra e Golden States fitoi 110-99 ndaj Portlandit në finalen e tretë të "play-off"-it mes dy ekipeve në Konferencën e Perëndimit, duke udhëhequr 3-0 serinë e takimeve. Kampionët e Warriorsit janë vetëm një fitore larg titullit kampion në Perëndim. Sfida e tretë e luajtur në Portland ishte me dy pamje, më e mirë për vendësit në pjesën më të madhe të lojës, që udhëhoqën deri në 18 pikë në periodën e dytë. Ai që shkëlqeu për skuadrën e Portlandit ishte McCollum me 23 pikë, por që s'mjaftuan për ta evituar humbjen. Pikërisht atëherë kur nuk pritej erdhi përmbysja e Golden States, të cilit i mjaftoi perioda e katërt për të dominuar në fushë dhe fituar takimin. Curry realizoi 36 pikë, duke qenë lider në fushë. Mirë u paraqit edhe Green, që realizoi një "triple double", me 20 pikë, 13 rebounde e 12 asistime,



raporton "Telesport". Edhe në këtë ndeshje mungoi Kevin Durant për Golden State i dëmtuar ashtu sikurse DeMarcus

Cousins. Ndeshja e katërt do të luhet në fushën e Portlandit, që ka shansin e fundit për ta rihapur garën për titull në Perëndim.

### KONFERENCA E LINDJES - FINALE "PLAY-OFF"

Milwaukee - Toronto (2-0)

### KONFERENCA E PERËNDIMIT - FINALE "PLAY-OFF"

Golden State - Portland 110-99 (3-0)

### SHKURT

#### Limani konfirmon bisedimet me Partizanin

Kapiteni i skuadrës së Dritës nga Gjilani, Ardian Limani, ka konfirmuar bisedimet me skuadrën e Partizanit të Tiranës. Mbrojtësi në fjalë nuk ka zbuluar se a do ta pranojë ofertën e klubit shqiptar. "Po, kam pasur kontakte me Partizanin. Është shumë i interesuar të nënshkruajmë me mua, por ende nuk kemi arritur ndonjë marrëveshje. Partizani është një nga skuadrat më të mëdha në Shqipëri dhe më vjen mirë që më ka vlerësuar dhe më kërkon. Personalisht ende nuk kam vendosur nëse do t'i bashkohem atij. Pas ndeshjes së fundit ndaj Ballkanit do t'i analizoj të gjitha ofertat dhe do ta marr vendimin përfundimtar", ka thënë Limani për "Telegrafin".

#### Tottenhami, 40 milionë euro për Zaniolon

Drejtuesit e skuadrës së Tottenham Hotspurit kanë nisur punë për ta përforcuar skuadrën për edicionin e ri. Mediet angleze raportojnë se në listën e "Spurs"-it është edhe talenti i Romës, Nicolo Zaniolo, për të cilin ekipi i drejtuar nga Mauricio Pochettino është gati t'i ofrojë Romës 40 milionë euro.

#### Bremeni nuk e lëshon Pizarron

Skuadra gjermane Werder Bremen ka vendosur t'ia vazhdojë kontratën edhe për një vit sulmuesit veteran Claudio Pizarro. Këtë e ka bërë me dije drejtori sportiv Frank Baumann, i cili ka thënë se lojtari do të nënshkruajë në ditët në vazhdim. 40-vjeçari Pizarro ka arritur të shënoj gol edhe në ndeshjen e fundit të kampionatit gjerman.

#### Presidenti i Napolit: Do ta merrja menjëherë De Rossin

Presidenti i Napolit, Aurelio De Laurentis, ka shfaqur admirimin për 36-vjeçarin Daniele De Rossi. Ai ka thënë se është i gatshëm ta marrë menjëherë mesfushorin i cili do të largohet nga Roma. "Do ta merrja menjëherë De Rossin. Është sikur ata t'ia kenë shitur Romën dikujt dhe në këmbim ta fshinin të shkuarën", ka thënë De Laurentis për "Sport Mediaset".

#### Kompany largohet pas 11 vjetësh nga City

Kapiteni Vincent Kompany largohet edhe zyrtarisht nga Manchester City pas plot 11 vjetësh. Mbrojtësi belg me Cityn arriti ta fitojë katër herë titullin kampion, dy herë FA Cup, katër kupa të Ligës dhe dy "Community Shields". Mbrojtësi belg numëron 360 ndeshje me "Qytetarët" dhe ka arritur të shënojë 20 gola. Mbrojtësi u transferua në Premierë Ligë në verën e vitit 2008, kur City asokohe pagoi 8.5 milionë euro te Hamburgu. "Ka ardhur koha të iki dhe çfarë sezoni kemi mbyllur! Nuk ndiej asgjë tjetër veç mirënjohjes. U jam mirënjohës të gjithë atyre që më kanë mbështetur në këtë udhëtim special, në një klub shumë special. Më kujtohet dita e parë aq qartë sa dita e fundit te City. Më kujtohet mirësia pa fund që mora nga populli i Manchesterit", ka deklaruar Kompany, i cili karrierën do ta vazhdojë në skuadrën e Anderletit.

#### Ajeti, Xhaka dhe Zhegrova fitojnë Kupën me Baselin

Tre futbollistët shqiptarë, Edon Zhegrova, Taulant Xhaka dhe Alban Ajeti, e kanë fituar Kupën e Zvicrës me Baselin pas fitores 2-1 në finale kundër Thunit të dielën në Bern. Golat nga sulmuesi shqiptar i Zvicrës, Alban Ajeti dhe nga Fabian Frei i mjaftuan Baselit për ta mundur Thunit në "Stade de Suisse". Anësori i ekipit kombëtar të Kosovës, Edon Zhegrova, ishte në bankën e rezervistëve në këtë takim final, po e fiton trofeun e tij të parë në karrierë me vetëm një minutë të lojës të zhvilluar në përgjithësi. Sulmuesi Ajeti bëri paraqitje të mirë dhe dha kontribut të madh duke e shënuar golin e parë të Baselit në minutën e 23-të. Frei e dyfishoi epërsinë rreth dhjetë minuta para fundit, para se Sorgic ta shënonte golin e vetëm të Thunit në këtë takim. Mesfushori i Shqipërisë, Taulant Xhaka, po ashtu luajti 90 minuta titullar.







# NASA, 50 vjet nga ulja në Hënë

*Disa sekrete rreth zbarkimit!*

**Agjencia Hapësinore Botërore,  
kërkon dëshmitarë për të  
treguar përvojën e tyre**

Në mbrëmjen e 20 korrikut 1969, Neil Armstrong dhe Buzz Aldrin ecnin në një terren që kurrë më parë nuk përshkohej nga këmbët njerëzore. Për të festuar përvjetorin e pesëdhjetë, grupi amerikan kërkon të regjistrojë një audio të shkurtër për ata që morën pjesë në ulje dhe dëshiron të tregojë pikëpamjen e tij në atë ditë.



**Projekti NASA për të  
përkujtuar Apollo 11**

Dita e madhe po vjen. Më 20 korrik bëhen pikërisht 50 vjet që nga ulja e hënës, nga ajo ndërmarrje që udhëhoqi dy anëtarë të Apollo 11, Neil Armstrong dhe Buzz Aldrin, për të ecur në një terren që kurrë nuk përshkohej nga këmbët njerëzore më parë. Në përgatitje për festimet, NASA ka menduar për një operacion shumë të veçantë: po u kërkon dëshmitarëve të dërgojnë kujtimet e tyre për atë natë magjike. Siç shpjegohet në faqen e projektit, agjencia kërkon të regjistrojë një audio të shkurtër në lidhje me atë që përfaqëson Hëna për atë që ishte aty atë natë dhe



çfarë do të donte të dinte më shumë rreth saj, çfarë do të thotë zbulimi hënor dhe si do të reagonte po të shikonte përsëri dikë që kalon satelitin tonë. Përgjigjet pastaj do të publikohen në rrjetet sociale, duke shënuar një rrugë që do të na çojë në ngjarjen e madhe të 20 korrikut.

**Më pak i fuqishëm se  
një makinë llogaritëse**

Për t'u përgatitur për datën e madhe ne kemi mbledhur disa kuriozitete teknologjike për misionin. Siç e dimë, kompjuterët luajtën një rol themelor në ulje. Jo vetëm ata në aeroplanët e hapësirës, por edhe ato në tokë. Ne gjithashtu e dimë se ata nuk ishin monstër të pushtetit, por për të qenë në gjendje t'i realizojnë ato është e mjaftueshme të mendosh për Apollo Guidance Computer (AGC). Përdorur në Modulin e Komandës dhe në LEM, ky kalkulator shfaqet i lashtë vetëm dhjetë vjet më vonë. Një IBM 8088 pc nga viti 1981 kishte tetë herë më shumë memorie se kolegu i saj hapësinor, 16 kBytes kundrejt 2 kBytes.

**Kompjuteri aq i madh sa  
një makinë**

Kishte edhe kompjuter në tokë, makina që ishin në gjendje të udhëzojnë njeriun në udhëtimin e tij prej 356 mijë kilometrash në hapësirë. Mostra ishte IBM System / 360 Model 75s, një kornizë aq e madhe sa një automobil dhe me një kosto të tepruar 3.5 milionë dollarë. Kjo të bën të mendosh se një mak-



inë llogaritëse moderne është më e fuqishme se ky elefant teknologjik, ndërsa një iPhone Xs është rreth 200 milionë herë më i shpejtë.

**Ulja flet italisht**

Kompjuterët e NASA-s flisnin

italisht. NASA bleu disa mostra të Olivetti P101, kompjuteri i parë personal në botë, për të përgatitur misionin e Apollo 11. Dy foto historike tregojnë "Perottina", ashtu siç u quajt me emrin e krijuesit të saj, Pier Giorgio Perotto, në tryezën e dy shkencëtarëve të NASA-s.

**Deri në 20 milionë  
spektatorë**

Ulje ishte ngjarja e parë globale mediatike. Sipas vlerësimeve, transmetimi i drejtpërdrejtë ka pasur rreth 530 dhe 600 milionë shikues anembanë globit. Një rekord i rrahur vetëm 12 vjet më vonë nga martesja e Dianës dhe Karlos që arriti në 750 milionë. Vetëm në Itali ngjarja u pasua nga 20 milionë njerëz përmes 7 milionë televizioneve: shumica e globit u ndal gjatë fazave kryesore të misionit, sikur të ishte goditur nga pezullimi i papritur. Dhe kjo përkundër orës: Armstrong në fakt e vuri këmbën në tokën hënore në orën 4.56 të kohës italiane.

**Pse thuhet "Houston,  
kemi një problem"**

E mbyllim me vendin më të rëndësishëm për festime, pra Houston, Teksas. Këtu është Lyndon B. Johnson Space Center, qendra e kontrollit për të gjitha fluturimet hapësinore. Kjo është arsyeja pse ne shpesh i dëgjojmë astronautët të fillojnë komunikimet e tyre duke thënë, për shembull, "Houston, kemi një problem". Sidoqoftë, dhoma e kontrollit Apollo 11 e restauruar në mënyrë të përkryer do të jetë e hapur për publikun në qershor dhe do të kthehet në kohë më 20 korrik 1969. Megjithatë, kulmi do të arrihet më 16 korrik, ditën e fillimit të Apollo 11 dhe do të vazhdojë deri më 24 korrik, kur tre astronautët u kthyen në Tokë. /Gazeta Shqip







MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRCJITHSHME/ DEPARTMENT OF FINANCES AND GENERAL SERVICES/ DEPARTMAN I FINANSIJA I GENERALNIH USLUGA

DIVIZIONI I BURIMVE NJRËZORË/ DIVISION OF HUMAN RESOURCES/ DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-149, Rregulloren Nr. 02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shpall:

## KONKURS

### I

Titulli i punës: Zyrtar i Lartë i Prokurimit

Institucioni: MKRS

Kategoria funksionale: Koficienti: 8

Numri i referencës: 29/2019

I përgjigjet: Udhëheqësit të Divizionit të Prokurimit

Vendi: Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë: Nën mbikëqyrjen e Udhëheqësit të Divizionit të Prokurimit, përmbushë detyrat dhe përgjegjësitë e poshtëshënuara:

- Harton planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të njësisë dhe jep rekomandime lidhur me realizimin objektivave të njësisë;
- Harton dhe zhvillon dokumentacionin e prokurimit, duke përfshirë edhe planin e blerjes, orarin e prokurimit, kërkesat për oferta, planin e vlerësimit, planin e negociimit dhe rekomandimin e blerjes;
- Analizon aktivitetet aktuale të prokurimit dhe rekomandon përmirësimin përmes metodave më efektive të prokurimit dhe standardizimit të procedurave të prokurimit;
- Siguron që të gjitha kërkesat për prokurim janë në pajtim me legjislacionin dhe rregullat e prokurimit publik;
- Përgatit kontrata dhe siguron që metodat e prokurimit dhe teknikat janë të kuptueshme dhe zbatohen nga ana zyrtare të prokurimit;
- Përgatit forma dhe procedura standarde, varësisht nga metoda e prokurimit dhe siguron që ftesat për oferta për tenderë dhe dërgimi i tyre është bërë me kohë;
- Siguron mbajtjen e të dhënave detale për të gjithë ofertuesit pjesëmarrës, për veprimet dhe vendimet e marra, si dhe nënshkrimi i komenteve nga secili anëtar;
- Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

### Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara:

- Diploma universitare, fakulteti ekonomik, juridik apo biznes, 3 vite përvojë pune profesionale;
- Njohuri dhe përvojë në fushën e prokurimeve dhe ligjeve, rregullore të aplikueshme në fushat e përgjegjësisë së ministrisë;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, Internetit).
- Vërtetimi që nuk është nën hetime.

### II

Titulli i punës: Inspektor në Inspektoratin e TK-së

Kategoria funksionale /Koficienti: 8

Numri i referencës: 26 /2019

I përgjigjet: Udhëheqësit të Inspektoratit për Trashëgimi Kulturorë

Vendi: Prizren

Detyrat dhe përgjegjësitë: Nën mbikëqyrjen e Udhëheqësit të Inspektoratit për Trashëgimi Kulturorë i kryen detyrat dhe përgjegjësitë e mëposhtme:

### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Harton planet e punës në koordinim me udhëheqësin;
- Kryen detyrat e parapara në planet e punës të miratuara në përputhje me ligjet, rregulloret, politikat dhe procedurat përkatëse, brenda afateve kohore të caktuara;
- Bën hulumtime, analiza, vlerësim të opsioneve dhe rekomandime për shqyrtim nga nivelet e larta rreth detyrave dhe planeve të miratuara;
- Verifikon në mënyrë të pavarur integritetin si dhe vlerëson kushtet dhe gjendjen e trashëgimisë kulturore, bazuar në dispozitat e Ligjit për Trashëgimi Kulturorë;
- Vepron në raport me intervenimet: ( konservim, restaurim, gërmime arkeologjike), për ndryshim apo shfrytëzim i veprimeve tjera ) që nuk janë ndërmarr më lejen e kërkuar me shkrim, bazuar në dispozitat e Ligjit për Trashëgimi Kulturorë;

- Këshillon autoritetin kompetent për ndërmarrjen e masave të duhura të ruajtjes, sanksionimit apo shpronësimit, sipas dispozitave të Ligjit për Trashëgimi Kulturorë;
- Koordinon punën dhe komunikon me institucionet vartëse të trashëgimisë kulturore dhe institucionet tjera relevante;
- Urdhëron ndërprejen e menjëhershme të çfarëdo veprimi të paautorizuar që dëmton trashëgimin kulturorë, bazuar në dispozitat e Ligjit për Trashëgimi Kulturorë;
- Kryen çdo detyrë tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe.

### Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:

- Të ketë njohuri të thella dhe të fituara, përmes shkollimit universitar, trajnimeve përkatëse;
- Diplomë Universitare ( Arkitekturë, Histori-Arkeologji, Etnografi, Juridik ) se paku 3 vite përvojë pune profesionale;
- Njohuri të ligjeve dhe rregullore të aplikueshme;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);
- Njohja e gjuhës angleze e domosdoshme, njohuri të gjuhëve tjera të huaja përparësi.
- Vërtetimi që nuk është nën hetime.

Procedurat e konkurrimit: Konkursi është i hapur për të gjithë kandidatët.

Kohëzgjatja e emërimit: Emërimi është me afat të pacaktuar.

Data e mbylljes së konkursit: Konkursi është i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë.

Data e fundit e aplikimit është: 03.06.2019

Aplikacionet e dërguara nëpërmjet postës, me pullë postare, në ditën e fundit të shpalljes, konsiderohen të vlefshme.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacioni shkarkohet nga Ueb faqja e MKRS-së dhe dorëzohet në zyrën 27 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Adresa: Sheshi "Nëna Terezë" Nr. 44, Prishtinë. Për informata shtesë kontaktoni në numrin 038211 449 dhe 038 211 921 ( apo në ueb-faqen <http://www.mkrs-ks.org/>.

**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Shullat, Rr. Bajram Kelmendi





MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA / MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME / DEPARTMENT OF FINANCES AND GENERAL SERVICES / DEPARTMAN I FINANSIJA I GENERALNIH USLUGA

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE / DIVISION OF HUMAN RESOURCES / DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Na osnovu Zakona o Civilnoj Službi Republike Kosova, Br. 03/L-149, Uredbe Br. 02/2010, o Procedurama Zapošljavanja u Civilnoj Službi Republike Kosova, Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta objavljuje:

## KONKURS

### I

Naziv radnog mesta: Viši Službenik za Nabavke

Institucija : MKOS

Funkcionalna kategorija: Koeficijent: 8

Referentni broj: 29/2019

Odgovara: Rukovodiocu Odeljenja za Nabavke

Mesto: Priština

Dužnosti i odgovornosti : Pod nadzorom Rukovodioca Odeljenje za nabavke , ispunjava dolo navedene dužnosti i odgovornosti:

1. Izrađuje planove rada u saglasnosti sa nadzornikom za izvršavanje zadataka utvrđenih na osnovu ciljeva jedinice i daje preporuke u vezi sa ostvarivanjem ciljeva jedinice;
2. Izrađuje i razvija dokumentaciju za nabavku, uključujući plan kupovine, raspored nabavke, zahteve za ponudu, plan procene, plan pregovora i preporuku o kupovini.
3. Analizirati tekuće aktivnosti nabavke i preporučuje poboljšanje putem efikasnijih metoda nabavke i standardizacije procedura nabavke;
4. Obezbeđuje da su svi zahtevi nabavke u skladu sa zakonodavstvom i pravilima javnih nabavki;
5. Pripremiti ugovor i osigurati da su metode i tehnike nabavke razumljive i da ih implementiraju drugi službenici za nabavku;
6. Pripremiti standardne obrasce i procedure, u zavisnosti od metode nabavke i osigurava da se pozivi na ponude i njihova dostava obavljaju na vreme.
7. Pruža detaljnu evidenciju za sve ponuđače koji učestvuju, o preduzetim radnjama i odluka, kao i za potpisivanje komentara od strane svakog člana;
8. Obavlja druge dužnosti u skladu sa zakonima i propisima koje nadzornik razumno može povremeno zahtevati.

### Kvalifikacija, i potrebne sposobnosti:

1. Univerzitetska diploma iz ekonomije, prava ili fakulteta o biznisu , minimalno 3 godine profesionalnog radnog iskustava.
2. Znanje i iskustvo u oblasti nabavki i zakona, važećih propisa u oblasti odgovornosti ministarstva;
3. Veštine na komunikaciju i planiranje rada i timskog rukovođenju;
4. Istraživačke, analitičke i veštine o proceni i formuliranje preporuka i stručnih saveta;
5. Sposobnost obavljanja poslova i rada pod pritiskom;
6. Poznavanje kompjuterski softverski programa (Word, Excel, Power Point, Access Internet);
7. Potvrda da nije pod istragom.

### II

Naziv radnog mesta: Inspektor Inspektorata za Kulturnu Baštinu

Funkcionalna Kategorija /Koeficijent: 8

Broj referencije: 26 /2019 za Kulturnu Baštinu

Odgovoran je: Rukovodiocu Inspektorata za Kulturnu Baštinu

Mesto: Prizren

Zadaci i obaveze: Pod nadzorom Rukovodioca Inspektorata za Kulturnu Baštinu izvršava zadatke i odgovoran je, kao u nastavku:

### Zadaci i odgovornosti:

1. Uređuje planove rada u koordinaciji sa rukovodiocem;
2. Izvršava zadatke predviđene planom delatnosti, prihvaćenih u podudarnosti sa zakonom pravilnicima, politikama i dotičnim procedurama, unutar određenih vremenskih rokova;
3. Vršiti istraživanja, analize, procenjivanje opcija i preporuka za razmatranje od visokih nivoa, oko prihvaćenih zadataka i planova;
4. Na nezavisan način proverava integritet i procenjuje uslove i stanje kulturne baštine, bazirajući se na odredbe Zakona za Kulturnu Baštinu;
5. Dejstvuje u odnosu sa intervencijama: ( konzerviranje, rekonstrukcije, arheološka iskopavanja), za izmenu ili korišćenje ostalih delatnosti ) koje nisu preduzete sa

dozvolom, pismeno zahtevanom, bazirajući se na odredbama Zakona o Kulturnoj Baštini;

6. Savetuje kompetentan autoritet za predizimanje potrebnih mera za očuvanje, sankcionisanje ili eksproprijaciju, prema odredbama Zakona za Kulturnu Baštinu;
7. Koordinira rad i komunicira sa zavisnim institucijama kulturne baštine i ostalim relevantnim institucijama;
8. Naređuje hitan prekid bilo koje neovlašćene delatnosti koja šteti kulturnu baštinu, bazirajući se na odredbe Zakona za Kulturnu Baštinu;
9. Izvršava i svaki drugi zadatak, u podudarnosti sa aktuelnim zakonom i pravilnicima, koji se razložno mogu zahtevati s vremena na vreme.

### Zahtevano obrazovanje, iskustvo, sposobnosti i lične karakteristike:

1. Da poseduje duboka dobijena znanjapreko univerzitetskog obrazovanja, dotičnih treniranja;
2. Univerzitetska Diploma ( Arhitektura, Istorija-Arheologija, Etnografija, Prava) najmanje 3 godine profesionalnog iskustva;
3. Poznavanje sprovodljivih zakona i pravilnika;
4. Istraživačka sposobnost, analitička, za procenjivanje i formulisanje preporuke i profesionalnih saveta;
5. Sposobnost u komuniciranju, planiranju rada i rukovođenja ekipom;
6. Kompjuterska sposobnost u aplikaciji programa (Word, Excel, Power Point, Access);
7. Poznavanje engleskog jezika je neophodno, znanje ostalih stranih jezika je od prednosti.
8. Potvrda da nije pod istragom.

Procedure konkurisanja: Konkurs je otvoren za sve kandidate.

Trajanje imenovanja: Imenovanje je na neodređeni rok.

Datum zatvaranja konkursa: Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) dana.

Poslednji datum za apliciranje je: 03.06.2019

Aplikacije koje se šalju putem pošte, sa poštanskim markicama, na poslednji dan konkursa, smatraju se važećim. Podnošenje zahteva: Aplikacija se preuzima sa veb stranice MKOS-a i dostavlja se u kancelariji 27 Ministarstva kulture, omladine i sporta, adresa: Trg "Majke Tereze" Br. 44, Priština. Za dodatne informacije stupite u kontakt na broj telefona 038211 449 i 038 211 921 (ili na veb stranici <http://www.mkrs-ks.org/>).

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► D.P.T."Venera 1" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër: 80111517

► Leotrim Hoti shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Faik Draga" Leqinë

► Arjanit Hyseni shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore cikli 1-5 "Shote Galica" Runik

► Fatmir Kastrati shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme gjimnaz "Hamëz Jashari" Skenderaj

► Arjanit Hyseni shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme teknike "Anton Çetta" Skenderaj

► Shaban Jashari shpall te pavlefshme diplomën + 3 dëftesat e shkollës se mesme teknike "Anton Çetta" Skenderaj.

► Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 bane-sa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi 52 000€. Për info 044/672-439.

► Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irno 044/672-439.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Shes banesën hyrja e 7 mbi kurriz te banesat e gjelbërta përball shkollës "Xhemajl Mustafa" e rinovuar tërësisht. Banesa ka 82 metra katror. 3 dhoma, sallon, shpajz dhe ballkon + taras me shfrytëzim. Çmimi 75000 Euro me para te gatshme, por bej edhe ndërrim me banesë me të vogël në Prishtinë ose banesë më të madhe në Fushë Kosovë sipas marrëveshjes. Numri kontaktues: 044 672 439

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

